



SHËRBIMET VENDORE DHE KOMUNITETI LGBT NË SHQIPËRI

Studim mbi nivelin e shërbimeve dhe perceptimet e
zyrtarëve publikë vendorë në 6 bashki të Shqipërisë



Tiranë, Maj 2016



SHËRBIMET VENDORE DHE KOMUNITETI LGBT NË SHQIPËRI

Autorë:

**Merita PONI
Altin HAZIZAJ**

© Ky botim i Ambasadës PINK mund të citohet, fotokopjohet apo printohet, por gjithnjë duke dhënë referencën përkatëse për autorët dhe organizatën. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të shitet apo botohet pa lejen me shkrim të Ambasadës PINK. Opinionet, mendimet, pikëpamjet dhe informacioni i dhënë në këtë botim jo detyrimisht shprehin opinionet, pikëpamjet apo qëndrimet e Ambasadës PINK apo ato të Bashkimit Europian.



Ky studim u realizua falë mbështetjes së
Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri.



Autorët:

Dr. Merita Poni

Altin Hazizaj (MA, LLM)

Ekipi ndihmës:

Amarildo Fecanji

Artan Karoli

Mersila Ballo

Dorina Recì

Referenca e botimit: Hazizaj A., Poni M., Shërbimet Vendore dhe komuniteti LGBT në Shqipëri, Ambasadë PINK, 2016.

© Foto: Marshimi i Krenarisë Athinë 2010, Ambasadë PINK.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve	4
Lista e tabelave dhe grafikëve	5
Mirënjohje dhe falenderime	7
1. Përmbledhje e përgjithshme	8
2. Hyrje: Të jesh LGBT në Shqipëri	14
3. Metodologjia e studimit	18
4. Kuadri ligjor dhe institucional në lidhje me të drejtat e personave LGBT në Shqipëri	22
5. Analiza e të dhënave: Shërbimet vendore dhe perceptimet e tyre përkundrejt komunitetit dhe personave LGBT në Shqipëri	28
6. Analiza e gjetjeve kryesore	79
7. Rekomandimet	84
Referencat	87

Lista e shkurtimeve

CEDAW	Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas
LGBT	Lezbike, gej, biseksual dhe transgjinator
INSTAT	Instituti i Statistikave
KDF	Konventa për të Drejtat e Femijës
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut
KP	Kodi Penal
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI (2016-2020)
RSH	Republika e Shqipërisë

Lista e tabelave

- TABELA 1:** Niveli i plotësimit dhe refuzimit të instrumentit të kërimit, nga zyrtarët publikë vendor në 6 Bashki
- TABELA 2:** Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor
- TABELA 3:** Gadishmëria për të ofruar shërbime sipas gjinisë dhe formimit
- TABELA 4:** Opinionet kryesore në lidhje me të drejtat e personave LGBT

Lista e grafikëve

- Grafiku 1: Shpërndarja e kampionit të pyetësorit sipas Bashkive
- Grafiku 2: Përkatësia e të anketuarve sipas vendit të punës
- Grafiku 3: Përkatësia e të anketuarve sipas sektorit të shëbimit
- Grafiku 4: Përkatësia e të anketuarve sipas gjinisë
- Grafiku 5: Përkatësia e të anketuarve sipas moshës
- Grafiku 6: Përkatësia e të anketuarve sipas nivelit arsimor
- Grafiku 7: Përkatësia e të anketuarve sipas studimeve universitare
- Grafiku 8: Gjendja civile e të anketuarve
- Grafiku 9: Përkatësia fetare
- Grafiku 10: Praktikimi i fesë
- Grafiku 11: Shërbimet që ofrohen nga Bashkitë
- Grafiku 12: A janë personat LGBT përfitues të shërbimeve të bashkisë?
- Grafiku 13: Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor
- Grafiku 14 : Mjedisi bashkiak dhe qëndrimet e punonjësve ndaj qytetarëve LGBT
- Grafiku 15: Ushtrimi i të drejtës për ankimim për aksesin dhe cilësinë e shërbimeve vendore
- Grafiku 16: Refuzimi i të drejtës për të marrë shërbime nga bashkia
- Grafiku 17: Dhuna verbale ndaj personave LGBT
- Grafiku 18: Dhuna fizike ndaj LGBT
- Grafiku 19: Konfliktet e personave LGBT me punonjësit vendore
- Grafiku 20: A duhet të marrin shërbime personat LGBT në bashki?
- Grafiku 21: Marrja e shërbimeve të veçuara për personat LGBT
- Grafiku 22: Gadishmëria e punonjësve për të ofruar shërbimet, sipas rretheve
- Grafiku 23: Gadishmëria e punonjësve sipas moshës
- Grafiku 24: Gadishmëria e punonjësve sipas formimit Universitar
- Grafiku 25: Gadishmëria e punonjësve sipas përkatësisë fetare
- Grafiku 26: Shërbimet e kërkuara nga personat LGBT pranë njësive të pushtetit vendor
- Grafiku 27: Grup-mosha e personave LGBT që kanë kërkuar shërbime në bashki

Grafiku 28: Mbrojtja e privatësisë së personave LGBT
Grafiku 29: Trajtimi i diferencuar i transgjiorëve ndaj LGBT
Grafiku 30: Sistem referimi për personat LGBT
Grafiku 31: Njohjet me persona LGBT
Grafiku 32: Njohjet me personat LGBT sipas rretheve
Grafiku 33: Rrethanat e njohjes me personat LGBT
Grafiku 34: Kontaktet me personat LGBT
Grafiku 35: Burimet e informacionit për personat dhe çështjen LGBT
Grafiku 36: Mbështetje protestave dhe marshimeve për të drejtat e personave LGBT
Grafiku 37: Opinione kryesore në lidhje me të drejtat e personave LGBT
Grafiku 38: Personat LGBT janë qytetarë si gjithë të tjerët
Grafiku 39: Personat LGBT kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët
Grafiku 40: Personat LGBT kanë të drejtë të punësohen në administratën publike
Grafiku 41: LGBT kanë të drejtë të frekuentojnë të njëjtat mjedise shërbimi
Grafiku 42: Personat LGBT kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat
Grafiku 43: Personat LGBT kanë të drejtë të martohen
Grafiku 44: Personat LGBT kanë të drejtë të krijojnë familje
Grafiku 45: Personat LGBT janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje
Grafiku 46: LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë
Grafiku 47: Personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta
Grafiku 48: Personat LGBT janë më inferiorë se të tjerët
Grafiku 49: A janë personat LGBT si gjithë qytetarët e tjerë?
Grafiku 50: Personat LGBT kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët (sipas gjinisë)
Grafiku 51: Personat LGBT kanë të drejtë të punësohen në administratën publike (sipas gjinisë)
Grafiku 52: Personat LGBT kanë të drejtë të frekuentojnë të njëjtat mjedise shërbimi (sipas gjinisë)
Grafiku 53: Personat LGBT kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat (sipas gjinisë)
Grafiku 54: Personat LGBT kanë të drejtë të martohen (sipas gjinisë)
Grafiku 55: Personat LGBT kanë të drejtë të krijojnë familje (sipas gjinisë)
Grafiku 56: Personat LGBT janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje (sipas gjinisë)
Grafiku 57: Personat LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë (sipas gjinisë)
Grafiku 58: Personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta (sipas gjinisë)
Grafiku 59: Personat LGBT janë më inferiorë se të tjerët (sipas gjinisë)
Grafiku 60: Trajnimet për të drejtat e LGBT
Grafiku 61: Trajnimet, shpeshësia e tyre
Grafiku 62: Trajnimet, sipas temave me interes
Grafiku 63: Trajnimet sipas fushës
Grafiku 64: Praktikë pune pozitive me LGBT
Grafiku 65: Sektor pune të veçantë për LGBT
Grafiku 66: Studime sociale ku përfshihet orientimi seksual
Grafiku 67: Arritjet në zbatimin e ligjit për mosdiskriminim
Grafiku 68: Sektorët ku duhet përfshirë mbrojtja e LGBT
Grafiku 69: Veprimtaritë që nevojiten aktualisht

Mirënjohje dhe falenderime

Studimi “Shërbimet Vendore dhe komuniteti LGBT në Shqipëri” është përpjekja e parë serioze e një organizate joqeveritare në Shqipëri, që punon për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të lezbikeve, gayve, biseksualëve dhe transgjjinorëve, për të paraqitur një tablo të situatës së shërbimeve në nivel vendor, si dhe perceptimeve e qendrimeve të zyrtarëve publikë vendore përkundrejt personave dhe komunitetit LGBT.

Ambasada PINK kërkon të falenderojë autorët e këtij studimi serioz, Dr. Merita Poni dhe z. Altin Hazizaj, për realizimin me sukses dhe rigorozitet të të gjithë procesit të përgatitjes së studimit, formulimit të rekomandimeve të prekshme, të cilat ne shpresojmë që të sjellin një ndryshim në mënyrën sesi qeverisja vendore në Shqipëri i përqaset komunitetit LGBT. Ambasada PINK falenderon znj. Pranvera Elezi për analizën statistikore dhe paraqitjen e të dhënave grafike të përfshira në studim.

Ne duam të falenderojmë përzemërsisht mbështetjen e vyer të Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri, të cilët financuan përgjatë dy viteve një ndër nismat më ambicioze për komunitetin LGBT, atë të sjelljes së një ndryshimi në mënyrën e të menduarit dhe të të ofruarit të shërbimeve në nivel vendor të zyrtarëve dhe drejtuesve në gjashtë ndër bashkitë kryesore në Shqipëri: Tiranë, Elbasan, Shkodër, Korçë, Durrës dhe Vlorë. Pa mbështetjen e BE-së ky studim nuk do të ishte bërë i mundur.

Po ashtu nuk mund të qendrojmë pa shprehur mirënjohjen tonë për të gjashtë Bashkitë e sipër-permendura. Falë mbështetjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me stafet dhe drejtuesit e tyre, u bë e mundur edhe shpërndarja e pyetësorëve, vlerësimi i të dhënave si dhe ndarja e eksperiencave në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të jetës, sigurisë dhe statusit të personave LGBT që jetojnë në këto gjashtë qytete të mëdha

Së fundmi, ne duam të shprehim mirënjohjen dhe falenderimin tonë të përzemërt për të gjithë stafin dhe ekspertët e Ambasadës PINK, në mënyrë të posaçme për Amarildo Fecanji, Artan Karoli, Blerina Metaj, Mersila Ballo dhe Dorina Reci, për lehtësimin e të gjithë procesit të shpërndarjes dhe të mbledhjes së pyetësorëve, duke respektuar edhe rregullat specifike të caktuara nga drejtuesit e studimit.

Në një fushë kaq të pa-studiuar, siç është kjo e të drejtave të personave LGBT, studime të tilla ndihmojnë politikë-bërësit, median, aktivistët, OSHC-të dhe agjensitë ndërkombëtare të njohin realitetin e vështirë me të cilin jetojnë personat LGBT dhe pritshmërisht së bashku mund të nisim të punojmë për ta ndryshuar këtë realitet, për ta bërë atë sa më të hapur dhe të barabartë për këdo.

AMBASADA PINK

1. Përmbledhje e Përgjithshme

Pavarësisht se Shqipëria ka bërë hapa përpara në drejtim të respektimit të të drejtave të personave LGBT, si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal, zyrtarët publikë dhe popullsia në përgjithësi vijojnë të ketë probleme me pranimin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personave LGBT. Ndonëse gjatë viteve të fundit ka patur një zvogëlim të dukshëm të rasteve të dhunës në publik përkundrejt personave LGBT dhe niveli i pranimit shoqëror ka ardhur duke u rritur, përsëri organizatat LGBT në vend vazhdojnë të raportojnë raste gjithnjë e në rritje të dhunës në familje, përjashtimit tërësor të personave transgjinerë, diskriminimit shoqëror dhe në vendin e punës, e për më tepër po vihet re gjithnjë e më shumë tendenca për t'u larguar nga vendi dhe për të kërkuar azil në vendet e Europës perëndimore¹.

Studimi “Sherbimet vendore dhe komuniteti LGBT në Shqipëri” është përpjekja e parë serioze për të vlerësuar nivelin e ofrimit të shërbimeve në nivel lokal nga zyrtarët publikë përkundrejt personave që i përkasin komunitetit LGBT. Ai ndër të tjera kërkon të identifikojë çështjet dhe shqetësimet më kryesore me të cilat komuniteti përballet kur kërkon apo përdor shërbimet vendore në nivel të bashkive. Në mungesë të këtyre studimeve, si në bazë shteti ashtu edhe në nivel rajonal apo europian, autorët janë përpjekur që të jenë sa më objektivë në analizimin e të dhënave dhe prezantimin gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij studimi. Në përfundim të këtij procesi, autorët arritën të identifikojnë një serë gjetjesh të cilat po i grupojmë në katër fusha kryesore, si më poshtë:

1.1 Gjetjet kryesore të studimit

- **Qendrimet negative** përkundrejt personave LGBT ndikojnë drejtëpërsëdrejt në cilësinë e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor. Rreth 9% e zyrtarëve publikë vendorë deklarojnë se kanë qendime negative (pra nuk duan) që t'i ofrojnë shërbime personave LGBT ndërsa 15% të tjerë janë të pasigurtë në këtë drejtim.;
- **Refuzimi i shërbimit (5%), dhuna verbale (7% në total) dhe fizike (3%) apo ngritja e shërbimeve të veçanta për personat LGBT (2.2 % dhe 6.3%)** janë tregues se mungesa e standarteve të komunikimit dhe supervizimit të ofrimit të shërbimeve inkurajon një pjesë të vogël të zyrtarëve publikë të jenë përjashtues, ndëshkues dhe diskriminues ndaj personave LGBT.
- **Gratë dhe vajzat zyrtare publike** janë më të hapura dhe mbajnë qëndrime më pozitive përkundrejt personave LGBT, krahasuar me djemtë dhe burrat.

¹ Raport i Situatës të të Drejtave të Njeriut të Personave LGBT në Shqipëri (2011-2014), Ambasada PINK. Aksesuar online në adresën: <http://www.pinkembassy.al/publikime/raporte-te-shkeljeve-te-te-drejtave-te-njeriut>

- **Feja dhe besimi fetar** nuk janë një faktor vendimtar që ndikon në mos-ofrimin e shërbimeve përkundrejt komunitetit LGBT, por as një faktor që duhet neglizhuar.
- Një ndër gjetjet kryesore të studimit ishte **niveli i lartë i mbështetjes së të drejtës për martesë dhe për të krijuar familje për personat LGBT**. Në kundërshtim me pritshmëritë dhe diskursin publik kunder martesës në gjini të njejtë, studimi gjeti se rreth 42% e zyrtarëve publikë vendore ishin dakord me martesën në gjini të njejtë dhe 34% për krijimin e familjeve LGBT.
- **Ka një nivel të lartë paragjykimesh, mos-pranimi apo refuzimi për barazinë midis personave LGBT dhe atyre heteroseksualë**. Kështu studimi arriti të identifikonte se 32% e të intervistuarve mendonin se personat LGBT janë më inferiorë se pjesa tjetër e qytetarëve; 24% e tyre mendojnë se personat LGBT nuk duhet të punësohen në administratën publike; 26% e të pyeturve thonë se personat LGBT nuk janë qytetarë si gjithë të tjerët dhe së fundmi 10% e zyrtarëve mendojnë se personat LGBT duhet të kenë më pak të drejta se të tjerët.
- Zyrtarët publikë kanë një nivel të lartë paragjykimesh dhe mos-pranimi përkundrejt **transgjinerëve**.
- Zyrtarët publikë kanë një **nivel tepër të ulët të njohjes së koncepteve për të drejtat LGBT** dhe si rrjedhojë edhe një mungesë në drejtim të marrjes së trainimeve përkatëse. Rreth 75% e të gjithë zyrtarëve vendorë të intervistuar deklaruan se nuk ishin trainuar asnjëherë në këtë fushë.
- Pavarësisht se Shqipëria ka një legjislacion të përparuar në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale, rreth **81% e zyrtarëve vendorë të intervistuar nuk ishin të informuar nëse të dhënat personale të personave LGBT** ishin trajtuar në një mënyrë të tillë që të garantonin privatësinë e tyre dhe mbrojtjen e identitetit të tyre në lidhje me orientimin seksual apo identitetin gjinor.

1.2 Rekomandimet kryesore të studimit

Rekomandime për Kuvendin e Shqipërisë

- Thirrja e seancave të vazhdueshme degjimore me përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe nga komuniteti LGBT në vend;
- Nxitja e vazhdueshme e institucioneve të të drejtave të njeriut për të përgatitur Raporte të Posaçme mbi çështje specifike të të drejtave të njeriut të personave LGBT;

- Përgatitja dhe miratimi i ligjeve të reja në fushën e të drejtave të njeriut të personave LGBT;

Rekomandime për Qeverinë Shqiptare

- Krijimi i një sektori për të drejtat e personave LGBT pranë Ministrisë së Mirëqenies;
- Mbështetja publike e lëvizjes dhe komunitetit LGBT;
- Përfshirja e komunitetit LGBT në çdo politikë zhvillimore e çdo ligj në këtë fushë.

Rekomandime për pushtetin vendor: Bashkitë

- Forcimi i kontakteve dhe bashkepunimit midis zyrtarëve publikë vendore dhe organizatave dhe përfaqësuesve të komunitetit LGBT. Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse apo kulturore në datën 17 Maj, që njihet edhe si dita ndërkombëtare kundër homofobisë;
- Zyrtarët publikë vendor kanë nevojë urgjente për trainime për të drejtat e njeriut dhe sidomos për konceptet LGBT;
- Çdo Bashki duhet të zhvillojë një politikë të mos-diskriminimit, ku përfshihet edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor, e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë zyrtarët apo të kontraktuarit e Bashkisë (njesisë vendore).

2. Të jesh LGBT në Shqipëri

Të jesh lezbike, gej, biseksual dhe transgjinnor nuk është diçka e lehtë. Si një orientim seksual apo identitet gjinnor², të qenit LGBT është parë dhe shihet ende nga shoqëria me paragjykime, qendrimi negativ deri tek dhuna apo urrejtja e hapur kundër çdo personi që dyshohet apo pranohet se është LGBT ose shoqërohet me ta.

Shqipëria e dekriminalizoi zyrtarisht homoseksualizmin në vitin 1995, me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal, 18 vjet pasi sistemi brutal komunist kishte vendosur të ndëshkojë orientimin seksual nëpërmjet Nenit 137 (Pederastia) të Kodit Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë³. Numri i personave që u dënuan përgjatë kësaj periudhe për kryerjen e marrëdhënieve me të njëjtin seks mbetet ende edhe sot e kësaj dite e panjohur. Ndonëse ka patur disa thirrje drejtuar Kuvendit, që të dëmshpërblejë dhe t'ju kërkojë ndjesë ndaj të gjithë të dënuarve për këtë vepër penale, deri më tani kjo nuk ka ndodhur⁴.

Rrëzimi i sistemit komunist dhe fillimi i ndryshimeve demokratike bënë të mundur edhe krijimin e një lëvizje modeste LGBT që në vitin 1994 u kurorëzua me krijimin e Shoqatës Gay Albania⁵, e para organizatë në historinë e Shqipërisë për të drejtat e komunitetit LGBT. Megjithatë u desh viti 2010 që Shqipëria të fillonte të fliste haptazi për personat LGBT.

Në 27 Shkurt 2010, Klodian Çela, një ndër pjesmarrësit e shfaqes televizive “Big Brother” foli haptazi për orientimin e tij seksual gay, gjë që shkaktoi një interes të paparashikuar nga media në atë kohë. Ndërkohë në qytetin, ku jetonte familja e tij, në Lezhë, mbi 100 persona dolën të protestonin, duke kërkuar ndër të tjera edhe largimin e tyre nga ky qytet. Çështja u bë aq shqetësuese sa detyroi edhe Sekretaren e Shtetit të SHBA-ve, Hillary Clinton, t'i kërkonte Shqipërisë që të mbronte të drejtat LGBT⁶. Thuajse një muaj më parë, Kuvendi i Shqipërisë kishte miratuar ligjin e ri për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili ndër të tjera i garantonte mbrojtje të posaçme edhe personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinnor.

² Orientimi seksual përshkruan një model ose strukturë të qëndrueshme tërheqjeje emocionale, romantike dhe seksuale ose kombinim të tyre kundrejt seksit të kundërt, seksit të njëjtë, të dyja seksve ose asnjërit prej seksve dhe gjinive që i shoqërojnë ato². Identiteti gjinnor është mënyra se si një njeri vet-identifikohet me një kategori gjinore, si për shembull të jesh femër ose mashkull, apo në disa raste asnjë prej tyre, i cili mund të jetë i dallueshëm nga seksi biologjik. – sipas përkufizimit të bërë nga Shoqata Amerikane e Psikologëve (APA)

³ Neni 137 i Kodit Penal të vitit 1977, nën termin “pederastia” thotë: Pederastia dënohet me burgim gjeri në 10 vjet”

⁴ Deklaratë Publike e Ambasadës PINK, për Dëmshpërblimin e të Dënuarve për Homoseksualizëm në periudhën komuniste (<http://www.pinkembassy.al/qeveria-t%C3%AB-d%C3%ABmshp%C3%ABrblej%C3%AB-t%C3%AB-gjith%C3%AB-personat-lgbt-t%C3%AB-d%C3%ABnuar-gjat%C3%AB-rregjimit-komunist>)

⁵ Gazeta “Koha Jonë”, Prill 1994. / Gazeta “Shqiptarja” Homoseksuali shqiptar: Ja si jetonim në kohën e monizmit (<http://shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=75719>)

⁶ Hillary Clinton diskuton për homofobinë në Shqipëri, mund të lexohet në këtë lidhje: <http://www.pinknews.co.uk/2010/06/24/hillary-clinton-discusses-subject-of-homophobia-in-albania/>

Pavarësisht se Shqipëria ka bërë hapa përpara në drejtim të respektimit të të drejtave të personave LGBT, si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal, zyrtarët publikë dhe popullsia në përgjithësi vijon të ketë probleme me pranimin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor të personave LGBT. Ndonëse gjatë viteve të fundit ka patur një zvogëlim të dukshëm të rasteve të dhunës në publik përkundrejt personave LGBT dhe niveli i pranimin shoqëror ka ardhur duke u rritur, përsëri organizatat LGBT në vend vazhdojnë të raportojnë raste gjithnjë e më në rritje të dhunës në familje, përjashtimit social tërësisht të personave transgjinorë, diskriminimit shoqëror dhe në vendin e punës, e për më tepër po vihet re gjithnjë e më shumë tendenca për t'u larguar nga vendi dhe për të kërkuar azil në vendet e Europës perëndimore⁷.

Për shkak të paragjytimeve të përhapura dhe homofobisë, shumica e personave LGBT në Shqipëri nuk e tregojnë seksualitetin e tyre në familje, në shkollë ose në vendin e punës. Orientimi seksual është kthyer, megjithatë, në një temë të diskutuar gjerësisht. Për shkak të mënyrës se si media e paraqet debatin mbi homoseksualitetin dhe të drejtat LGBT, ai bëhet gjithnjë e më shumë një subjekt për polemika.

Në raportet e të Drejtave të Njeriut të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe në Raportin e Progresit të Bashkimit European, Shqipëria vijon të kritikohet në lidhje me mungesën e marrjes së masave pozitive për të mbrojtur, përkrahur dhe mbështetur personat LGBT. Situata bëhet edhe më e prekshme në gjirin e partive politike, ku asnjë prej partive politike parlamentare në Shqipëri nuk e përmend fare komunitetin LGBT në vend në statutet dhe programet e tyre politike⁸. Shqipëria u vlerësua vetëm me 34 pikë në vlerësimin e përgjithshëm të ILGA-Europe Rainbow Map 2016, shumë herë më poshtë se thuajse të gjitha vendet e Bashkimit European⁹.

Ka pak të dhëna mbi gjendjen e diskriminimit në shërbimet publike dhe private përsa i përket komunitetit LGBT. Mungesa e studimeve, rasteve, vlerësimeve apo ankesave, është një tregues ndër të tjera edhe i mungesës së njohjes së mbrojtjes që ofron ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri, kulturës së mos-ankimit dhe sigurisht frikës për bërjen publike të orientimit seksual apo identitetit gjinor nga familja apo edhe publiku i

⁷ Raport i Situatës të të Drejtave të Njeriut të Personave LGBT në Shqipëri (2011-2014), Ambasada PINK. Aksesuar online në adresën: <http://www.pinkembassy.al/publikime/raporte-te-shkeljeve-te-te-drejtave-te-njeriut>

⁸ Ambasada PINK, Manifesti i të Drejtave LGBT për Zgjedhjet Parlamentare 2013;

⁹ ILGA-Europe Harta e Ylberit 2016, http://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Attachments/side_b-rainbow_europe_index_may_2016_small.pdf

gjerë. Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në raportin e saj të posaçëm për komunitetin LGBT, ndër të tjera shkruan¹⁰:

Vëmë re se ka homofobi jo vetëm në ambientet shkollore apo të punës, por edhe në ofrimin e shërbimeve... Diskriminimi ndaj personave LGBT lidhet me paraqitjen e tyre të jashtme ose sjelljen. Personat që nuk sillen ose nuk jetojnë sipas “normave” shoqërore, janë shpesh viktima të diskriminimit në të gjitha mjediset; familje, shkolle, pune, rrugë dhe mjedise publike. Komuniteti ka raportuar për sjellje diskriminuese në njësi tregtare shërbimesh, përmes qëndrimeve armiqësore apo mohimit të ofrimit të shërbimit.

¹⁰ Vendimi i zyrës së Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr.5, date 23.01.2014.

3. Metodologjia e studimit

Qëllimi i këtij studimi është të masë nivelin e aksesit, të dhënies së shërbimeve, të perceptimeve dhe qendrimeve pranuese ose diskriminuese nga përfaqësuesit e institucioneve të qeverisjes vendore në 6 bashki të Shqipërisë përkundrejt personave LGBT që jetojnë në këto qytete.

Objektivat e këtij kërkimi ishin:

- Matja e perceptimeve, qendrimeve dhe nivelit të shërbimeve të ofruara nga pushtetit vendor përkundrejt personave LGBT në Shqipëri;
- Vëzhgimi i faktorëve personalë dhe institucionalë dhe roli që ato luajnë në drejtim të ofrimit të shërbimeve vendore për personat LGBT;
- Njohja me barrierat që mund të ndikojnë në ofrimin ose mos-ofrimin e shërbimeve publike vendore nga ana e zyrtarëve publik përkundrejt personave LGBT;
- Pasja e një tabloje të përgjithshme të situatës së shërbimeve vendore dhe nivelit të ofrimit të këtyre shërbimeve dhe përgatitja e një liste me rekomandime për politikë-bërësit dhe vendim-marrësit në Shqipëri;

Ky kapitull ofron një këndvështrim të detajuar mbi metodat e përdorura në këtë studim, në funksion të objektivave dhe qëllimit të kërkimit, duke përshkruar popullatën e studimit, metodat e analizës së të dhënave, konsideratat etike dhe kufizimet e tij.

3.1. Tipologjia e studimit

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat e këtij kërkimi dhe për të adresuar pyetjet kërkimore të studimit, është përzgjedhur një përfaqëse metodologjike sasiore, ku kampioni u përcaktua duke marrë në konsideratë numrin e të punësuarve në sektorin publik pranë gjashtë bashkive: Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë dhe Vlorë, si dhe duke studiuar sektorët e shërbimit që pushtetiti vendor ka për detyrë të ofrojë përkundrejt banorëve të tyre. Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara si edhe kampioni nuk janë përfaqësues në nivel kombëtar, pavarësisht tendecave, diferencave apo të përbashkëtave që kampioni mund të tregojë nëpërmjet krahasimit nga bashkia në bashki.

3.2. Instrumentet kërkimore dhe mbledhja e të dhënave

Rishikim dokumentash e raportesh - Në fazën e parë të studimit u rishikuan një sërë dokumentash e raportesh në lidhje me situatën, të drejtat dhe homofobinë përkundrejt komunitetit LGBT në Shqipëri. Kjo fazë e studimit u përqëndrua gjithashtu në shqyrtimin e dokumentave politikë dhe kuadrit ligjor për personat LGBT. Pjesë e kësaj analize janë gjithashtu edhe treguesit dhe gjetjet nga analiza, raporte vlerësimi dhe studime kombëtare e ndërkombëtare në këtë fushë. Duhet thënë se edhe studimet ndërkombëtare në këtë fushë janë ende shumë të kufizuara. Të dhënat sasiore për këtë studim u mbledhën në periudhën gjysmës së vitit 2015 dhe të dhënat u analizuan përgjatë vitit 2016.

Qasja Sasiore. Studimi u zhvillua në një mjedis ku më parë nuk ishin zhvilluar anketa apo studime të mëparshme në fushën e caktuar nga kërkimi. Studiuesit përgatitën instrumentin (pyetësor) përgjatë vitit 2015 dhe e testuan atë paraprakisht në dy fokus grupe me përfaqësues të përzgjedhur nga të gjitha bashkitë pjesë e studimit. Instrumenti i kërkimit përmbante 32 pyetje, të cilat mund të ndahen të 4 fusha: aspekte të përgjithshme të të intervistuarit (qyteti, mosha, gjinia), aspekte personale të të intervistuarit (martesa, formimi, besimi fetar etj), perceptimet personale ndaj personave LGBT (niveli i pranimi ose refuzimit), qendrimet personale përkundrejt personave LGBT (niveli i shërbimit apo refuzimi sipas shkakut etj), e së fundi edhe nevoja për trainime apo njohja e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Studiuesit vendosën që instrumenti i kërkimit (Pyetësi) të vetë-plotësohej nga punonjësit e pushtetit vendor, për të shmangur çdo influence apo ndërhyrje nga intervistues të jashtëm, për shkak edhe sepse bëhej fjalë për një temë sensitive, ku zyrtarët mund të ndjeheshin nën presion për të performuar më mirë, nëse do të intervistoheshin nga një person i panjohur.

3.3. Popullata e studimit

Popullata e këtij studimi (kampioni) ishin vetëm përfaqësues të niveleve të ndryshme hierarkike apo të profesioneve dhe pozicioneve të ndryshme në gjashtë Bashki të Shqipërisë, të cilat së bashku banohen thuajse nga 2/3 e popullësisë në Shqipëri. Bashkitë u zgjedhën për shkak të zbatimit të projektit të Ambasadës PINK të mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Europian në këto 6 bashki dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet organizatës PINK dhe bashkive.


Në total u shpërndanë 350 pyetësorë në total në të gjitha Bashkitë, nga 50 pyetësorë për çdo bashki, me përjashtim të Tiranës, ku për shkak të numrit të lartë të të punësuarve në Bashki, krahasuar me Bashkitë e tjera, u ndanë 100 pyetësorë. Në total u dorëzuan të plotësuar 64.2% e pyetësorëve, ose e thënë ndryshe vetëm 35.8% e zyrtarëve vendorë nuk e plotësuan ose refuzuan ta plotësojnë instrumentin e studimit.

TABELA 1: Niveli i plotësimit dhe refuzimit të instrumentit të kërimit, nga zyrtarët publikë vendor në 6 Bashki

Rrethi	Nr. i pyetësorëve të shpërndarë për Bashki	Nr. i pyetësorëve të plotësuar	% e pyetësorëve të plotësuar për Bashki
Durrës	50	27	54
Elbasan	50	32	64
Korçë	50	23	46
Shkodër	50	41	82
Tiranë	100	55	55
Vlorë	50	47	94
Total	350	225	64.2

Nga të dhënat sasiore të mbledhura nga studimi i kampionit të intervistuar, na rezulton se në total 224 persona që punonjnë si specialistë dhe si drejtues të njësive vendore në 6 bashki: Durrës (11.6%), Elbasan (14.2%), Korçë (10.3%), Shkodër (18.3%), Tiranë (24.6%) dhe Vlorë (21.0%). Ashtu siç edhe shihet nga përqindjet, Tirana mban peshën kryesore të pyetësorëve të dorëzuar dhe të plotësuar, e ndjekur më pas nga Shkodra etj.

Shpërndarja e kampionit



3.4. Konsideratat etike

Në ndjekje dhe respektimin e parimeve etike, mbi të cilin është ngritur ky studim, në asnjë prej rasteve studiuesit nuk ushtruan presion gjatë rekrutimit dhe përfshirjes në studim. Subjektet e mundshme u pyetën nëse ishin të interesuar për të marrë pjesë në studim dhe u

informuan në lidhje me kontributin e tyre nga pjesëmarrja në këtë studim. Në disa raste, subjektet e përzgjedhur vendosën të mos merrnin pjesë në studim. Subjekteve të kërimit iu bë e qartë se pjesëmarrja e tyre nuk ishte e detyrueshme dhe ishte e drejta e tyre për të mos marrë pjesë apo për t'u tërhequr nga studimi në çdo kohë, apo edhe e drejta për të mos iu përgjigjur pyetjeve që mund të ishin të ndjeshme për ta. Subjektet u informuan paraprakisht për përzgjedhjen e tyre, qëllimin e studimit dhe kohëzgjatjen e plotësimit të pyetësorit dhe iu kërkua të jepnin miratimin e tyre për t'u përfshirë ose jo në studim.

Studiuesit u treguan mjaft të kujdesshëm në respektimin e konsideratave etike, si:

- *Fshehtësia dhe mirëbesimi i plotë* – të dhënat e marra për qëllimin e këtij studimi u trajtuan në formë të fshehtë dhe në mirëbesim të plotë dhe nuk u përdorën për qëllime të tjera, përveç atij të shpallur.
- *Anonimati* – të gjithë bisedat dhe pyetësorët u zhvilluan duke respektuar të drejtën për të ruajtur anonimin. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes, subjektet u siguruan që informacioni i dhënë prej tyre do të trajtohej në mënyrën më konfidenciale të mundshme.

3.5. Kufizimet e studimit

Ky studim nuk merr përsipër të përgjithësojë gjetjet e tij përtej grupit të synuar dhe të studiuar. Të gjitha opinionet e ndara nga subjektet e këtij studimi, janë ruajtur në formën e tyre origjinale dhe nuk mund të përgjithësohen përtej nivelit krahasimor ndërmjet bashkive.

Duke qenë se ky studim u ndërtua krejtësisht brenda qëllimit të tij dhe mbi të dhëna që nuk kishin si qëllim të përshkruanin përjetimet reale apo viktimizimin e çdo personi LGBT. Ai nuk merr përsipër të përshkruajë situatën e të drejtave të personave LGBT në këto 6 bashki apo nivelin e viktimizimit të personave LGBT nga mos-dhënia e shërbimeve prej punonjësve publikë në Bashki. Analiza e të dhënave është bazuar vetëm dhe në atë çka kanë deklaruar vetë punonjësit. Vlefshmëria e rezultateve u provua gjatë workshopit që u organizua për këtë qëllim me përfaqësues të niveleve të ndryshme nga të 6 Bashkitë pjesëmarrëse në këtë ushtrim kërkimor.

4. Kuadri ligjor dhe institucional në lidhje me të drejtat e personave LGBT në Shqipëri

4.1. Aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948). Deklarata sanksionon parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit në një dispozitë të vetme (neni 7) që parashikon se “Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) në Nenin 26 thekson: “...ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtetë tjetër”.

Konventa mbi Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1994. Si shtet anëtar në CEDAW Shqipëria ka raportuar 2 herë në komitetin përkatës të konventës, përfshi edhe të drejtat e LBT-ve;

Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, ndër të tjera garanton mbrojtjen e integritetit fizik, mendor dhe seksual të çdo personi nën moshën 18 vjeç.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1996. Neni 14 i KEDNJ, Protokolli Nr. 12 i KEDNJ-së dhe Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbështesin të drejtën për të mos u diskriminuar për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Karta Sociale Evropiane (ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2002) sanksionon parimin e barazisë (neni 20) duke përcaktuar në mënyrë të shprehur se “Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit” dhe parimin e mosdiskriminimit (neni 21).

Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”, Komiteti i Ministrave, rekomandon shtetet që të marrin masa në drejtim të garantimit të së drejtës për jetën, sigurinë dhe mbrojtjen nga dhuna, të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

4.2 Legjislacioni shqiptar për të drejtat e personave dhe komunitetit LGBT

Kushtetuta e Shqipërisë në një serë dispozitash të saj ka synuar nxitjen e respektimit të barazisë dhe mosdiskriminimit (kryesisht neni 18, por edhe nenet 16 e 20)¹¹. Kushtetuta nuk e parashikon shprehimisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor si shkak për diskriminim.

Kodi Penal përtej eliminimit të kriminalizimit nuk ofroi për një kohëtë gjatë mbrojtje të posaçme për personat LGBT. Falë një përpjekjeje të Avokatit të Popullit dhe të Ambasadës PINK, në vitin 2013 Kodi përfshiu ndryshime të rëndësishme që bëjnë të mundur mbrojtjen e personave LGBT nga gjuha e urrejtjes (Neni 253 dhe 265) apo duke caktuar si rrethanë rënduese krimet që mund të bëhen kundër tyre (Neni 50).

Kodi i Familjes (Neni 7) thotë se "martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç". Ky nen në mënyrë të qartë ndalon martesën mes personave të të njëjtit seks, përfshi edhe bashkëjetesën. Adoptimi i një fëmije gjithashtu nuk lejohet për çiftet e të njëjtit seks, neni 242 të Kodit të Familjes parashikon se "I mituri nuk mund të biresohet nga shume persona, pervec rastit kur ata jane bashkeshorte", që do të thotë se një person LGBT mund të adoptojë një fëmijë por vetëm si individ.

Kodi i Punës (i ndryshuar në vitin 2016) përfshiu për herë të parë në mbrojtjen nga diskriminimi edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor, falë kërkesave të vazhdueshme të Avokatit të Popullit dhe Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Neni 9 i Kodit¹², paragrafi 2, paraqet të gjitha elementet se kur ndalohet diskriminimi në marrëdhëniet e punës.

Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për personat dhe komunitetin LGBT përbën një hap pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ky ligj përmban një listë jo shteruese shkaqesh, për të cilat ofron mbrojtje nga sjellja diskriminuese, dhe parashikon shprehimisht mes tyre edhe orientimin seksual dhe identitetin gjinor¹³. Gjithashtu ligji jep përkufizimet e një sërë konceptesh të rëndësishme si diskriminim i drejtpërdrejtë, diskriminim i tërthortë, diskriminim për shkak të shoqërimit, viktimizimi etj.

¹¹ Në nenin 18 Kushtetuta parashikon: 1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

¹² Me "diskriminim" kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

¹³ Neni 1 i ligjit përcakton se qëllimi i tij është "zbatimi dhe respektimi i parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (2015) cakton detyrimet që kanë bashkitë, si njësitë e vetme administrative në nivel lokal përkundrejt banorëve të saj, përfshi edhe personat LGBT. Neni 3 i këtij ligji ndër të tjera garanton se vetëqeverisja vendore duhet të bëhet “në respekt të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera.” Po ashtu Neni 123 i të njëjtit ligj përcakton edhe përgjegjësinë e bashkive për të ofruar shërbime sociale në territorin e tyre për të gjithë banorët, përfshi edhe strehimin social.

Ligji për Arsimin Para-universitar në Shqipëri (2013) në vijim të rekomandimeve të institucioneve të të drejtave të njeriut dhe në zbatim të Konventës për të Drejtat e Femijës, përfshiu për herë të parë edhe mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të orientimit seksual, por la jashtë për arsye që nuk dihen identitetin gjinor. Ndër të tjera ligji parashikon ngritjen e Komisioneve të Etikës pranë çdo shkolle për të trajtuar rastet e dhunës apo diskriminimit ndaj femijëve apo edhe mësuesve.

4.3. Politika kombëtare për personat LGBT në Shqipëri

Në vijim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përgjatë vitit 2011, Qeveria e Shqipërisë dhe respektivisht Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, punoi për të përgatitur një plan modest veprimi në mbështetje të komunitetit LGBT.

Plani i Veprimit për Mos-Diskriminimin për Shkak të Orientimit Seksual dhe Identitet Gjinor 2012-2014, ndër të tjera pati si fokus edhe përmirësimin e shërbimeve publike kombëtare dhe lokale për komunitetin LGBT. Plani parashikonte informimin e komunitetit LGBT në Shqipëri për të drejtat e tyre në lidhje me aksesin në shërbimet publike. Në një raport të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Këshillit të Europës, vlerësohej fakti që thujse i gjithë plani i veprimit në lidhje me shërbimet ishte realizuar falë punës së organizatave joqeveritare të komunitetit LGBT, por asnjë masë nuk ishte ndërmarrë nga qeveria në këtë drejtim¹⁴.

Në Maj 2016, në kuadër edhe të IDAHOT (Dita ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë), Qeveria e Shqipërisë miratoi një plan të ri kombëtar masash në mbështetje të komunitetit LGBT, i cili ishte konsultuar më parë dhe gjerësisht me të gjithë institucionet publike dhe grupet e interesit.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë (2016-2020), është ngritur mbi tre qëllime strategjike, ku i treti i dedikohet: “Përmirësimi i aksesit në shërbimet e punësimit, edukimit, shëndetësisë, strehimit dhe sporteve për personat LGBTI, duke garantuar mundësi dhe të drejta të barabarta.” Qëllimi strategjik numër 3 në këtë politikë kombëtare është zhvilluar për të gjetur zbatim në 6 objektiva, si më poshtë:

¹⁴ REPORT ON THE ACTION PLAN FOR NON-DISCRIMINATION ON THE BASIS OF SEXUAL ORIENTATION AND GENDER IDENTITY 2012-2014, Alida Tota, Ministry of Labor, Social Affairs and Equal Opportunities.

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e punësimit për personat LGBTI nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimin të punëdhënësve dhe ofrimit të programeve lehtësuese për punësim.

Objektivi 3.2: Të reduktohet diskriminimi mbi LGBTI në arsim nëpërmjet rishikimit të kurrikulave në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit të punonjësve arsimorë.

Objektivi 3.3: Të përmirësohet aksesin dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor nëpërmjet përfshirjes të çështjeve LGBTI në programet parandaluese dhe ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë.

Objektivi 3.4: Të përmirësohet situata e strehimit të personave LGBTI nëpërmjet krijimit të programeve lehtësuese të strehimit dhe shërbimeve të standartizuara të strehimit të sigurt.

Objektivi 3.5: Të përmirësohet aksesin i personave LGBTI në ambientet sportive komunitare duke reduktuar diskriminimin.

Objektivi 3.6: Të përmirësohen legjislacioni dhe politikat përfshirëse të azilit për personat LGBTI.

Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI (2016-2020) udhëhiqet nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe parashikon një sistem më rigoroz të monitorimit të Planit, krahasuar me planin e kaluar (2012-2014) duke ngritur në të njëjtën kohë edhe Grupin Kombëtar të Zbatimit dhe Koordinimit (GKZK) për të monitoruar zbatimin e ecurisë së PKV 2016-2020.

4.4. Kuadri Institucional për të drejtat e personave LGBT

Kur marrin më shqyrtim kuadrin institucional në Shqipëri, për të parë nga afër se cilët janë institucionet që kanë përgjegjësi dhe detyrë, për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut të komunitetit LGBT, mund të themi se në tërësi ato përbëjnë një numër jo të vogël. Më poshtë po listojmë institucionet më kryesore.

Kuvendi i Shqipërisë, ka ndër të tjera për detyrë të zhvillojë legjislacionin, të informohet mbi gjendjen e të drejtave të personave LGBT si dhe të miratojë raporte apo rezoluta që mundësojnë gëzimin e barabartë të të drejtave për çdo qytetarë. Në këtë aspekt, janë një seri komisionesh dhe nën-komisionesh që mund të kryejnë një seri detyrash për të garantuar që të drejtat e personave LGBT respektohen. Një listë e shkurtër do të përfshinte:

- Komisioni Parlamentar për Ligjet;
- Komisioni Parlamentar për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale;
- Komisioni Parlamentar për Arsimin etj;
- Nën-komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut;
- Nën-komisioni Parlamentar për të Miturit dhe Dhunën në Familje.

Qeveria e Shqipërisë, ka për detyrë jo vetëm zhvillimin e politikave të reja për respektimin e të drejtave të njeriut të personave LGBT, por ndër të tjera edhe të kërkojë llogari për gjendjen e këtyre të drejtave dhe njëkohësisht të planifikojë në kohë dhe në sasi fondet shtetërore që do të duhen për të bërë të mundur gëzimin e këtyre të drejtave, qoftë nëpërmjet ofrimit shërbimeve më të mira, ashtu edhe në drejtim të mbrojtjes Ligjore, trainimit të stafeve, financimit të bashkive etj. Qeveria i realizon këto qëllime dhe objektiva nëpërmjet një serë ministrive dhe institucioneve publike, shkurtimisht si vijon:

- **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**, përgjegjëse ndër të tjera edhe për zbatimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, marrëdhëniet e punës, financimin e shërbimeve sociale dhe për të rinjtë, zhvillimin e politikave dhe standarteve të reja të shërbimeve socialeve etj. Ministria e ushtron këtë rol nëpërmjet një serë institucionesh si Shërbimi Social Shtetëror, Agjensia Kombëtare për të Rinjtë, Agjensia Kombëtare për Fëmijët, Inspektoriati i Punës, Inspektoriati i Shërbimeve Sociale etj;
- **Ministria e Arsimit**, ka ndër të tjera për detyrë të zhvillojë standartet e mbrojtjes së fëmijëve dhe adoleshentëve nga dhuna dhe bulizmi, trainimin e vazhdueshëm të mësuesve, financimin e shërbimit psikologjik në shkolla dhe përmirësimin e vazhdueshëm të teksteve dhe kurikules së nxënësve;
- **Ministria e Shëndetësisë** luan një rol primar në garantimin e shërbimeve shëndetësore, standarteve dhe politikës kombëtare të shëndetit, si dhe rritjen e gamës së kujdesit shëndetësor në nivel primar, sekondar dhe terciar. Ndër të tjera luan një rol kryesor edhe në promovimin jetësor të shëndetshme, mbrojtjes nga HIV/AIDS, shëndetin mendor etj;
- **Ministria e Drejtësisë** është një ndër organet kryesore të Qeverisë për Zhvillimin e legjislacionit në fushën e të drejtave të njeriut, përmirësimin legjislativ të Kodeve dhe njëkohësisht edhe nxitjen e miratimit të ligjeve të reja për njohjen e identitetit gjinor, bashkëjetesën apo martesën etj. Është gjithashtu përgjegjëse për Zhvillimin e politikës penale dhe garantimin e kushteve më të mira për të dënuarit në burgje dhe në paraburgim, përfshi këtu edhe shërbime specifike për personat transgjinorë psh;
- **Ministria e Brendshme** është përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen e rendit publik. Ndër të tjera ajo duhet të garantojë politika dhe standarte të reja për të gjithë punonjësit e policisë të të gjitha niveleve, trainimin e vazhdueshëm të tyre, në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Gjatë vitete të fundit është vërejtur re një ndryshim pozitiv në sjelljen e policisë përkundrejt komunitetit LGBT, falë edhe trainimeve si vendase ashtu edhe nga misionet e huaja të policisë;

Bashkitë janë institucionet përgjegjëse për ofrimin e të gjitha shërbimeve bazë që ndodhen në territorin e tyre dhe që me ligjin e pushtetit vendor i kanë kaluar atyre kompetencat e administrimit. Reforma e re territoriale e vitit 2015 dhe zgjedhjet vendore të të njëjtit vit, sollën një riorganizim të plotë të administratës vendore dhe ngritjen e 61 bashkive në të

gjithë Shqipërinë, duke eliminuar komunat dhe duke i kthyer bashkitë në zona urbane, peri-urbane dhe rurale. Ndër të tjera bashkitë, nëpërmjet departamenteve dhe drejtorive të tyre, janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale në territorin e tyre, strehimin social, transportin, pastrimin, punësimin lokal, nxitjen e praktikave të mira të mbështetjes së qytetarëve në nevojë. Këshilli Bashkiak pranë çdo bashkie është përgjegjës për miratimin e vendimeve më të rëndësishme të Bashkisë, përfshi edhe planifikimin dhe shpërndarjen e buxhetit vendor sipas prioriteteve të caktuara nga kryetari/ja i/e bashkisë.

Avokati i Popullit, është i vetmi institucion i Pavarur i të drejtave të njeriut i njohur nga Kushtetuta e Shqipërisë. Roli kryesor i zyrës së avokatit të popullit është mbrojtja e të drejtave të njeriut nga shkeljet që i vijnë nga sjellja shtetërore e zyrtarëve publike dhe institucioneve publike. Zyra e Avokatit të Popullit ka luajtur një rol jashtëzakonisht pozitiv në drejtim të promovimit dhe mbështetjes publike të të drejtave të barabarta për çdo person LGBT, përfshi edhe marrjen pjesë në marshimet publike të komunitetit LGBT. Përgatitja e raporteve të posaçme nga ana e Avokatit e ka rritur nivelin e ndërgjegjësimit të institucioneve në lidhje me situatën e të drejtave të personave LGBT kudo në Shqipëri;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucioni kryesor i të drejtave të njeriut i caktuar nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi për monitorimin e zbatimit të normave të ligjit si dhe për vendosjen në vend të çdo shkelje të të drejtave të personave për shkak të diskriminimit. Rasti i parë që trajtoi zyra e Komisionerit kishte të bënte me një shkelje të ligjit nga një politikan përkundëjt komunitetit LGBT. Në ndryshim nga zyra e Avokatit të Popullit, Komisioneri ka të drejtë jo vetëm të jap rekomandime drejtuar institucioneve, porë dhe të vendosë gjoba për shkelje të ligjit si ndaj subjekteve publike ashtu edhe atyre private të të drejtës.


Organizatat LGBT në Shqipëri janë nxitëset kryesore të lëvizjes modeste për të drejtat LGBT në vend. Falë edhe mbështetjes së organizatave të të drejtave të njeriut vendase dhe misionëve të huaja prezente në Shqipëri, ato ia kanë dalë të përballen suksesshëm me një pjesë të mirë të argumentave kundër barazinë në të drejta për komunitetin LGBT, sidomos me institucionet fetare, si dhe janë angazhuar në Zhvillimin e politikës kombëtare të qeverisë për komunitetin LGBT, organizimin e trainimeve dhe Studimeve të reja në fushë, dhe organizimin e iniciativave publike për të rritur vizibilitetin e lëvizjes LGBT, si psh Tirana Pride (Ambasada PINK), Marshimi i Biçikletave (Aleanca / Së bashku për LGBT) dhe mbështetjen e prindërve dhe familjeve të personave LGBT (OMSA). Ka një serë organizatash të tjera që mbështesin lëvizjen LGBT, sidomos organizata e grave, të të rinjve dhe të të drejtave të njeriut.

5. Analiza e të dhënave: Shërbimet vendore dhe perceptimet e tyre përkundrejt komunitetit dhe personave LGBT në Shqipëri

5.1 Të dhënat demografike


Përkatësia e të anketuarve sipas vendit të punës

Të anketuarit ishin punonjës të administratës vendore në pozicionet specialist dhe drejtues sektori shërbimesh publike vendore. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 185 prej tyre, janë specialistë të shërbimit publik vendor, ndërsa 39 janë drejtues. Kjo ndarje është e arsyeshme pasi reflekton shpërndarjen e pozicioneve të punës nëpër institucionet publike sipas rangjeve të hierarkisë burokratike, sipas së cilës numrin më i madh i punonjësve përfaqësohet nga specialistët, ndërsa numri i drejtuesve është më i pakët. Rreth 82.6 për qind e të anketuarve punonjnë si specialistë dhe 17.4 për qind si drejtues të sektorëve të shërbimeve publike.




Përkatësia e të anketuarve sipas sektorit të shërbimit

Punonjësit e anketuar punojnë në sektorët e mbrojtjes sociale si administratorë socialë që mbulojnë ndihmën ekonomike, nevojat për strehim, punonjës të sektorit të arsimit parauniversitar, punonjës së burimeve njerëzore, të gjendjes civile, të barazisë gjinore, të sektorit të planifikimit urban, financiar, etj.



Përkatësia e të anketuarve sipas gjinisë


Përqindjen më të lartë të të anketuarve e zenë punonjëset vajza dhe gra të cilat përbëjnë 72.2 për qind, ndërsa 21.4 për qind janë burra. Vetëm tre persona nuk e kanë shënuar gjininë kur janë përgjigjur. Numri i lartë i vajzave dhe grave në studim justifikohet me përqindjen e lartë të të punësuarve vajza dhe gra të punësuar në administratën



publike në nivel qendror dhe vendor. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave (INSTAT), në vitin 2014, administrata shtetërore kishte punësuar më shumë femra se sa meshkuj dhe më konkretisht 60 për qind të punësuarve në punë me pagesë në administratën shtetërore ishin vajza dhe gra. Administrata shtetërore punëson 49.4 për qind të të punësuarve në punë me pagesë. .

Përkatësia e të anketuarve sipas moshës


Përsa i përket moshës, të anketuarit janë ndarë në 5 grup-mosha me intervale 10-vjeçare: 19-30 vjeç, 31-40 vjeç, 41-50 vjeç, 51-60 vjeç, mbi 60 vjeç – deri në moshë pensioni 65 vjeç. Përgjithësisht, të punësuarit në administratën vendore janë me shkollë të lartë, madje me gradën master, do me thënë mbi 25 vjeç, kështu që numri i të punësuarve nën moshën 25 vjeç është shumë i pakët. Vetëm 8 punonjës, ose 3.5 për qind janë të moshës 19-24 vjeç.



Siç vihet re edhe nga të dhënat e kërimit, administrata vendore ka një moshë relativisht të re. Pjesa më e madhe e të anketuarve, 59.4 për qind, janë të grup-moshës 19-40 vjeç, ndërsa 39.7 për qind janë të grup-moshës 41-60 vjeç. Vetëm 3.0 për qind janë mbi moshën 60 vjeç. Përqindja e lartë e grup-moshës 20 - 40 vjeç në administratën vendore, e përfaqësuar me rreth 60 për qind të të anketuarve, është një tregues i rëndësishëm për perceptimet kulturore që ata kanë në lidhje me të drejtat e personave me orinetim seksual të ndryshëm nga ai heteroseksual.

Përkatësia e të anketuarve sipas nivelit arsimor

Për të kuptuar nëse niveli i tolerancës në perceptimet dhe qëndrimet e punonjësve të administratës vendore ndaj homoseksualëve ndikohet prej nivelit arsimor, të anketuarit janë përzgjedhur edhe sipas nivelit të arsimit: të mesëm dhe të lartë. Qëllimi ka qenë të kuptohet nëse arsimi ka ndikim në perceptimet kulturore dhe tolerancën ndaj diversitetit seksual. Shumica dërrmuese e të anketuarve janë me shkollë të lartë, 93.3 për qind, ndërsa një pakicë e vogël prej 7.7 për qind janë më shkollë të mesme, kjo për arsyen se administrata shtetërore punëson përgjithësisht persona me shkollë të lartë.




Përkatësia e të anketuarve sipas studimeve universitare

Punonjësit e njësive vendore janë përgjithësisht me shkollë të lartë. Pjesa më e madhe e tyre, 29.9 për qind, kanë formim nga shkenca e ekonomisë. Ata pasohen nga punonjës me profil të shkencave sociale si sociologji, filozofi, punë sociale, shkenca politike dhe psikologji, të cilët përbëjnë 18.8 për qind të punonjësve të administratës vendore. Rreth 14.3 për qind e të punësuarve janë me formim juridik, rreth 12.5 për qind janë me profesion mësues dhe 10.8 për qind janë inxhinierë të profileve të ndryshëm si ndërtues, arkitektë, mekanikë, informaticienë, etj. Vetëm një përqindje e vogël, 1.3 për qind kanë formim universitar nga shkenca e mjekësisë, si mjekë dhe infermierë.


Gjendja civile e të anketuarve

Shumica e të anketuarve, 65.6 për qind janë të martuar. Rreth 25.9 për qind janë beqarë, shifër kjo e justifikuar po të kihet parasysh përqindja e grup-moshës së re, 19-30 vjeç të punësuar në administratën vendore që përbëjnë 30 për qind të saj. Brenda kësaj grup-moshe një pjesë, 4.9 për qind janë bashkëjetues. Një përqindje e vogël e të anketuarve, 3.6 për qind janë të divorcuar dhe të ve.



Përkatësia fetare


Në përgjithësi, të anketuarit, rreth 90.0 për qind janë shprehur për përkatësinë e tyre fetare, se cilit besim i përkasin ata vetë ose familjet e tyre, ndërsa rreth 09.0 për qind nuk janë shprehur qartësisht, duke preferuar të mos deklarojnë besimin, duke deklaruar se janë agnostikë, pra besojnë tek



hyjnorja ose zoti, por jo tek një fe e veçantë ose duke deklaruar se janë ateistë. Ata që kanë deklaruar përkatësinë fetare vetjake ose familjare të familjes janë në shumicë të besimit islam 53.6 për qind, ndër të cilët 44.6 për qind janë myslimanë syni dhe 8.9 për qind janë bektashinj. Besimtarët e krishterë janë 37.5 për qind, ndër të cilët pjesa më e madhe janë ortodoksë 24.6 për qind, të pasuar nga katolikët 11.2 për qind dhe një përqindje e vogël protestantë 1.8 për qind.

Praktikimi i fesë

Nga të dhënat del qartë se shumica e të anketuarve 87.5 për qind nuk janë praktikantë të besimit. Ata ose nuk shkojnë nëpër institucionet fetare, 31.7 për qind, ose shkojnë vetëm për raste festash 55.8 për qind.



Ata që e praktikojnë besimin janë një pakicë prej 12.3 për qind, ndër të cilët shumica, 7.6 për qind, shkojnë në kishë ose në xhami vetëm një herë


në muaj, ndërsa ata që shkojnë një herë në javë janë edhe më pak 3.1 për qind, kurse ata që shkojnë për ditë janë vetëm 1.8 për qind.

5.2 Shërbimet që ofron pushteti vendor dhe niveli i tyre

Shërbimet që ofrohen nga Bashkitë

Bashkitë kryejnë veprimtari të ndryshme ndër të cilat një pjesë kanë të bëjnë me qytetarët dhe një pjesë me funksionimin e brendshëm të aparatit burokratik të bashkisë. Shërbimet që i ofrohen drejtëpërdrejtë qytetarëve janë ndihma ekonomike, strehimi, gjendja civile, informacioni, ndërsa shërbimet e tjera të bashkisë janë të lidhura me funksionet operacionale të institucionit si sektori financiar, ligjor, urban, burimet njerëzore, etj.

Sektorët e shërbimit publik



A janë personat LGBT përfitues të shërbimeve të bashkisë?

Në lidhje me shërbimet që marrin personat LGBT pranë zyrave të bashkive, të anketuarit janë shprehur se përgjithësisht ata nuk diskriminojnë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve pavarësisht orientimit seksual ose përkatësive të tjera social-kulturore. Pjesa më e madhe e punonjësve të administratës vendore të anketuar, rreth 50.9 për qind janë shprehur se ofrojnë shërbime për personat LGBT, njësoj si për të gjithë qytetarët e njësive administrative. Ndërsa rreth një e treta e punonjësve, rreth 31.3 për qind shprehen se nuk mbulojnë sektorë shërbimesh ndaj qytetarëve, por punojnë në sektorë të brendshëm të bashkisë, prandaj nuk u ka qëlluar të ofrojnë shërbime për qytetarët, përfshirë këtu edhe personat LGBT. Rreth 17.9 për qind e të anketuarve nuk kanë dhënë një përgjigje të qartë nëse ofrojnë shërbime për qytetarët LGBT. Pasiguria në dhënien e një opinioni të qartë lidhet me faktin se personat LGBT nuk janë identifikuar prej tyre si një grup i veçantë personash, por si të gjithë qytetarët e tjerë.

Këto opinione të të anketuarve janë përforcuar edhe prej përgjigjeve që ata kanë dhënë në lidhje me dendurinë e kontakteve që kanë me personat LGBT, në kuadër të punës së tyre, si punonjës bashkie. Kështu, rreth 84.0 për qind e punonjësve bashkiakë janë shprehur se, ndër qytetarët që kanë kërkuar shërbime prej bashkisë, nuk kanë mundur të identifikojnë se cilët kanë qenë persona LGBT. Vetëm 16.0 për qind janë shprehur se kanë ofruar shërbime për personat LGBT përgjatë punës vjetore, me një dënduri të rrallë kontaktesh.

Gjithësesi, edhe pse shprehen se nuk kanë mundur të dallojnë mes qytetarëve që kanë kërkuar shërbime ose kanë pasur kontakte me administratën vendore se kush ka qenë person LGBT, shumica e punonjësve, 83.9 për qind, janë shprehur se do t'i ofronin shërbim vetë ose duke i referuar tek shërbimet e tjera që mund të ishin më të përshtatshme për kërkesat e tyre si qytetarë. Janë shumë pak punonjës që refuzojnë t'i ofrojnë shërbime personave LGBT, vetëm 4.9 për qind. Ndërsa 5.8 për qind nuk janë të sigurtë se si do të sillleshin nëse do t'ju kërkoheshin shërbime prej personave LGBT.

Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor


Të anketuarit janë pyetur edhe për perceptimet që ata kanë për shërbimin që iu ofrohet qytarëve LGBT nga ana e bashkisë. Informacioni i marrë ndriçon disa aspekte cilësore të shërbimit vendor që lidhen me trajtimin korrekt dhe mikpritës për qytetarët, me mundësinë e tyre për t'u ankuar, nëse nuk janë të kënaqur me shërbimet, me qëndrimet armiqësore ndaj LGBT dhe shfaqjen e sjelljesve diskriminuese ndaj tyre nga ana e administratës bashkiake. Në tabelën e mëposhtme përmbledhen opinionet e të anketuarve për mënyrën se si u shërbehet personave LGBT nga administrata vendore.

TABELA 2: Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor					
Trajtimi nga shërbimi publik në nivel vendor në %	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Pa përgjigje	Total
A u krijohet një mjedis mikpritës kur vijnë të marrin shërbime?	9.4	11.2	64.7	14.7	100
A kanë mundësi ankimi për shërbimin?	10.7	17.4	52.7	19.2	100
A kërcënohen me mosmarrje shërbimi?	70.5	7.2	4.9	17.4	100
A ushtrohet dhunë verbale ndaj tyre (sharje, fyerje, komente denigruese, etj)?	75	4.9	1.8	18.3	100
A ushtrohet dhunë fizike ndaj tyre (shtyrje, hedhje, goditje, terheqje me force, etj)?	78.6	2.7	0.4	18.3	100
A ka pasur konflikte me punonjës?	77.7	5.3	0	17	100

Mjedisi bashkiak dhe qëndrimet e punonjësve ndaj qytetarëve LGBT

Sic shihet edhe nga grafiku, shumica e të anketuarve rreth 65.0 për qind deklarojnë se personave LGBT iu ofrohet një mjedis mikpritës kur shkojnë për të marrë shërbime në bashki. Në fakt këtë opinion të anketuarit e kanë për shërbimin që ofrojnë vetë për të gjithë qytetarët në përgjithësi, përfshirë edhe LGBT, pra përgjigja e tyre nuk ka të bëjë specifikisht

me personat LGBT, pasi ata i konsiderojnë këta si të gjithë qytetarët e tjerë. Duke qenë se të anketuarit japin një vlerësim të punës së tyre si ofrues shërbimesh, ata tentojnë ta paraqesin punën e tyre si shumë pozitive, prandaj shumica deklarojnë se janë miqësorë me qytetarët. Një përgjigje më e vërtetë se sa mikpritës janë punonjësit e shërbimit bashkiak në punën e tyre do vinte nga përfituesit më shumë se sa nga ofruesit e shërbimit. Prandaj perceptimi i ofruesve të shërbimit se ata janë miqësorë me ata të cilëve iu ofrojnë shërbim lipset të ballafaqohet me perceptimet e përfituesve të shërbimit, që në rastin e studimit janë personat LGBT. Megjithatë, perceptimi shumicës së të anketuarve se ata janë miqësorë me qytetarët është një tregues pozitiv për predispozitën që ata kanë për t’iu shërbyer qytetarëve LGBT.




Gadishmëria për të shërbyer pa diskriminim, konfirmohet nga pjesa më e madhe e punonjësve të anketuar (76.0 për qind) që shprehen se nëse personat LGBT do këkronin shërbime pranë bashkisë, administrata vendore do të ishte përgjithësisht miqësore (65.0 për qind) ose do mbante një qëndrim korrekt (11.0 për qind).

Edhe pse përgjithësisht punonjësit vendorë duken të predispozuar t’u ofrojnë shërbime qytetarëve LGBT, pa i diskriminuar, jo të gjithë shprehen se mjedisi shoqëror në administratën është miqësor ndaj tyre. Janë rreth 9.0 për qind punonjësit që shprehen se personeli i bashkisë nuk është mikpritës ndaj personave LGBT, duke nënkuptuar se punonjësit bashkiakë nuk do të ishin të gatshëm të ofronin shërbime për personat LGBT, megjithëse janë nëpunës shtetërorë. Ndërsa rreth 15.0 për qind e punonjësve janë të pasigurtë nëse bashkia ofron aktualisht një mjedis mikpritës për personat LGBT apo jo. Kjo pjesë e punonjësve të pasigurtë për qëndrimet ndaj personave LGBT dhe e atyre që shprehen se aktualisht punonjësit bashkiakë nuk janë mikpritës për qytetarët LGBT përbëjnë rreth 24.0 për qind të të anketuarve. Kjo përqindje është tregues i mungesës së një mjedisi mikpritës në administratën vendore dhe gjithashtu sinjalizon për nevojën që ka administrata vendore për të marrë më shumë informacion rreth të drejtave të LGBT, në mënyrë që t’u ofrojnë atyre shërbime publike vendore dhe një mjedis miqësor.

Ushtrimi i të drejtës për ankimim për aksesin dhe cilësinë e shërbimeve vendore

Ofrimi i shërbimit publik është një detyrim ligjor dhe moral për organizmat shtetërorë, në nivel qendror dhe vendor. Qytetarët e pakënaqur nga shërbimi kanë të drejtë të ankohen nëse shërbimi iu mohohet ose iu ofrohet me cilësi të dobët. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe qytetarët LGBT, prandaj një ndër çështjet e kërimit ishte të shqyrtohej edhe mundësia që kishin personat LGBT të ankoheshin për mungesë shërbimi ose për shërbim jo të mirë.



Nga të dhënat del qartë se rreth gjysma e punonjësve të anketuar, 53.0 për qind, shprehen se personat LGBT kanë të drejtë të ankohen për shërbimet dhe kanë mundësi ta ushtrojnë këtë të drejtë. Por, një pjesë e të anketuarve, rreth 17.0 për qind, shprehen se mundësia për t'u ankuar për aksesin dhe cilësinë e shërbimeve nuk ushtrohet

gjithmonë, por me raste. Ndërsa, rreth 11.0 për qind e punonjësve të anketuar mendojnë se pavarësisht të drejtës së ankimit, personat LGBT nuk kanë asnjë mundësi të ankohen për shërbimet vendore. Nuk është e qartë nëse kjo pamundësi për të ushtruar të drejtën e ankimit qëndron vetëm për qytetarët LGBT apo për të gjithë qytetarët e pakënaqur. Për të parë nëse kjo e drejtë nuk ushtrohet vetëm për personat LGBT, nevojitet të bëhet një studim cilësor që të pasurojë tablonë e kërkimit me më shumë të dhëna. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 19.0 për qind shprehen se nuk janë të sigurtë nëse qytetarët LGBT kanë mundësi të ushtrojnë të drejtën e ankimit për cilësinë dhe aksesin tek shërbimet bashkiake apo jo, shifër kjo që flet për mos-ushttrimin e të drejtës së ankimit për qytetarët.

Refuzimi i të drejtës për të marrë shërbime nga bashkia



Përgjigjet e dhëna nga shumica, rreth 71.0 për qind e të anketuarve, në lidhje me faktin nëse personave LGBT iu mohohet e drejta për të marrë shërbim nga ana e administratës vendore janë përgjithësisht negative, pra ata nuk kërcënohen me refuzim shërbimi. Pjesa tjetër, rreth 12.0 për qind e punonjësve janë përgjigjur se personat LGBT kërcënohen të mos marrin shërbime nga ana e administratës vendore,


prej të cilëve 7.0 për qind shprehen se kjo mund të ndodhë *ndonjëherë*, ndërsa 5.0 për qind shprehen se mund të ndodhë *shpesh*.

Rreth 17.0 për qind e të anketuarve nuk kanë ditur se si t'i përgjigjen pyetjes se ç'ndodh me personat LGBT nëse kërkojnë shërbime në bashki. Kjo pasiguri buron prej faktit se ata nuk janë përballur shpesh me persona LGBT dhe nuk dinë se si të reagojnë nëse ndodhin situata të tilla në punë. Mungesa e përgjigjes le të nënkuptohet që personave LGBT mund edhe t'ju refuzohet shërbimi publik. Pra, për qindja e punonjësve që mendojnë se personat LGBT

mund të kërcënohen me mosmarrje shërbimi nga ana e bashkisë është e konsiderueshme, rreth 29.0 për qind.

Dhuna verbale ndaj LGBT

Të anketuarit u pyetën edhe nëse ishin në dijeni të dhunimit të personave LGBT gjatë marrjes së shërbimit publik. Ata u pyetën specifikisht për llojin e dhunës verbale të ushtruar ndaj LGBT si: sharje, fyerje, komente denigruese dhe forma të tjera të dhunës verbale.




Shumica e të anketuarve, 75.0 për qind, u shprehën se personat LGBT nuk janë dhunuar asnjëherë verbalisht prej punonjësve të bashkisë. Një gjë e tillë sipas tyre nuk kishte gjasa të ndodhte as në të ardhmen, pasi ata janë qytetarë si gjithë të tjerët dhe meritojnë të

trajtohen me dinjitet. Ndërsa një përqindje e vogël prej 5.0 për qind mendon se personat LGBT mund të kenë hasur ndonjëherë në dhunë verbale, kur kanë kërkuar shërbime prej punonjësve të bashkisë ose do të trajtoheshin në mënyrë joetike prej tyre. Janë plotësisht të bindur se personat LGBT dhunohen verbalisht prej punonjësve të bashkisë vetëm 2.0 për qind e të anketuarve. Bindja e tyre buron prej faktit se punonjësit e bashkisë, sikurse shumica e popullsisë, janë homofobe dhe të painformuar për të drejtat e personave LGBT.

Përqindja e të anketuarve që nuk janë të sigurtë nëse personat LGBT dhunohen verbalisht apo jo prej punonjësve të bashkisë është relativisht e konsiderueshme, 18.0 për qind. Ata dyzohen të japin një përgjigje të saktë për këtë pyetje pasi, nga njëra anë mendojnë se punonjësit e bashkisë janë relativisht homofobë dhe nga ana tjetër, mendojnë se kërkesat etike institucionale të komunikimit të personelit me qytetarët do t'i frenonin punonjësit të shprehnin hapur qëndrimet homofobe dhe t'i artikulonin në sjellje të dhunshme. Përdorimi i hapët i dhunës do t'i ekspozonte punonjësit ndaj ndëshkimit institucional ose edhe penal për sjellje joetike dhe refuzim shërbimi. Frika nga ndëshkimi mund të frenonte shfaqjen e gjuhës së urrejtjes në publik dhe gjatë ushtrimit të detyrës, pavarësisht ndjesive homofobe. Prandaj një përqindje e tillë shprehen të pasigurtë nëse ndaj LGBT ushtrohet apo jo dhunë verbale. Nëse do të merreshin sëbashku, përgjigjet se ndaj personave LGBT ushtrohet dhunë gjithmonë, ndonjëherë dhe mbase, atëherë përqindja shkon në 25.0 për qind që është një shifër shqetësuese, pasi përfaqëson opinionin e çerekut të punonjësve bashkiakë. Kështu rezulton se afërsisht një ndër tre punonjës mendon se personat LGBT dhunohen verbalisht.

Dhuna fizike ndaj LGBT

Të anketuarit janë shprehur në shumicë, 79.0 për qind, se personat LGBT nuk dhunohen fizikisht në mjediset e bashkisë. Përqindja e atyre që mendojnë se ata mund të dhunohen fizikisht është e vogël, vetëm 3.0 për qind. Megjithatë, sikurse për dhunën verbale, edhe për dhunë fizike ndaj LGBT ka një përqindje prej 18.0 për qind të të anketuarve që nuk janë të sigurtë. Me sa duket janë po të njëjtit ata që shprehen të pasigurtë rreth ushtrimit të dhunës verbale dhe fizike ndaj LGBT. Arsytet e hezitimit të dhënies së një përgjigjeje të qartë janë të njëjta si për dhunën verbale.



Përqindja e përfillshme prej 18.0 për qind e të anketuarve të pasigurtë është një sinjal shqetësues për atë çka mund t'u ndodhë aktualisht ose që mund t'u ndodhë në të ardhmen personave LGBT, nëse drejtohen pranë bashkisë për shërbime. Mungesa e përgjigjes së qartë në


fakt është pohim i shqetësimit të qartë të një pjese të punonjësve bashkiakë se personat LGBT mund të dhunohen në mjediset bashkiake për shkak të të qenit të ndryshëm.

Konfliktet e personave LGBT me punonjësit vendore

Të anketuarit janë përgjigjur në një masë të konsiderueshme, rreth 78.0 për qind, se nuk kanë pasur konflikte me personat LGBT gjatë punës së tyre. Ata e japin këtë përgjigje në kuadër të perceptimit të gjerë të konflikteve me qytetarët në përgjithësi. Pra meqë nuk kanë pasur konflikte me qytetarët, për pasojë nuk kanë patur as me qytetarët LGBT. Një përqindje prej 5.0 për qind të anketuarish janë shprehur se kanë pasur konflikte me qytetarët, ndër të cilët ndonjë mund edhe të kenë qenë person LGBT.

Është e paqartë nëse ata që janë konfliktuar me punonjësit e bashkisë për këtë 5.0 për qindësh kanë qenë persona LGBT apo qytetarë jo LGBT. Pra kur përgjigjen se personat LGBT kanë pasur ndonjëherë konflikte me punonjës të bashkisë, të anketuarit mund të kenë parasysh dy alternativa, e para është që punonjësit e bashkisë mund të konfliktohen ndonjëherë me qytetarët, përfshirë këtu edhe ata LGBT, ndërsa e dyta që punonjësit e bashkisë konfliktohen specifikisht me personat LGBT për arsye se keta janë kulturalisht antikonformistë. Pra të dyja alternativat janë hipotetike.

A ka pasur konflikte me punonjës?



Një pjesë e të anketuarve, 17.0 për qind e kanë lënë pa përgjigje këtë pyetje, pasi nuk kanë ditur të thonë nëse punonjësit e bashkisë janë konfliktuar apo jo me personat LGBT. Si edhe në përgjigjet e lartpërmendura, pasiguria e të anketuarve lidhet me mosidentifikimin e personave LGBT ndër qytetarët me të cilët bashkëpunojnë punonjësit e bashkive ose me mosdijeninë e tyre mbi praninë e konflikteve mes punonjësve të bashkisë dhe qytetarëve në përgjithësi dhe atyre LGBT në veçanti.


5.3 Gadishmëria e zyrtarëve vendorë për t'i shërbyer personave LGBT

Një ndër pyetjet që iu drejtua punonjësve të bashkive ishte edhe ajo që lidhej me opinionet e tyre se ku duhet të marrin shërbim personat LGBT. Nëpërmjet kësaj pyetjeje zbulohet se ç'qëndrim kanë punonjësit vendorë në lidhje me zbatimin e së drejtës së marrjes së shërbimeve publike nga ana e qytetarëve LGBT. Në këtë seksion pyetjet kryesore janë: (i) a duhet të marrin personat LGBT shërbim e në bashki apo në institucione të veçuara; (ii) nëse duhet t'i marrin shërbimet veç të tjerëve, në të mirë të kujt është veçimi?; (iii) a do t'i ofronin punonjësit shërbime personave LGBT apo do t'i refuzonin dhe do t'i referonin për shërbim diku tjetër? Të dhënat në këtë seksion janë analizuar në mënyrë të desagreguar sipas përcaktorëve socio-demografikë siç janë: mosha, gjinia, rrethi, niveli arsimor dhe përkatësia fetare. Synimi i analizës së desagreguar është të kuptohet nëse elementët e përkatësisë shoqërore kanë ose jo ndikim në gadishmërinë e punonjësve për t'iu ofruar shërbime personave LGBT.

A duhet të marrin shërbime personat LGBT në bashki?

Në përgjithësi, të anketuarit, rreth 90 për qind shprehen se personat LGBT duhet të marrin shërbime në bashki si gjithë qytetarët e tjerë. Një pjesë e të anketuarve, rreth 11 për qind shprehen se: personat LGBT nuk duhet të marrin shërbime në bashki, por shërbime të veçuara të destinuara vetëm për ata, se personat LGBT duhet t'i marrin shërbimet veç të tjerëve, se duhet të mos marrin shërbime në bashki ose se nuk e dinë se ku duhet t'i marrin.

A duhet të marrin shërbime në bashki personat LGBT?




Megjithëse e ulët, rreth 22.2 për qind, përqindja e personave që mendojnë se personat LGBT duhet të mos marrin shërbime në bashki dhe se duhet t'u ofrohet shërbim veç të tjerëve është shqetëuese. Këtë opinion e ka pothuajse një ndër dhjetë punonjës të bashkisë. Ka shumë gjasa që nëse një person LGBT do t'i drejtohej ndonjërit prej këtyre punonjësve për shërbim, të refuzohej dhe të mos e merrte shërbimin për të cilin punonjësi është i detyruar profesionalisht t'ia ofrojë. Ndër ata që mendojnë se personat LGBT duhet të mos marrin shërbime në bashki, peshën më të lartë në përqindje e zënë punonjësit që mendojnë se personat LGBT duhet të marrin shërbim veç të tjerëve. Ky opinion edhe pse nuk u mohan të drejtën e marrjes së shërbimeve personave LGBT, u mohan këtë të drejtë si një shërbim të përbashkët (mainstream). Madje për të qenë korrektë se përse personat LGBT duhet të mos marrin shërbime të përbashkëta me të tjerët në bashki, ata justifikohen me arsyen se personat LGBT kanë nevojë për shërbime të specializuara, të destinuara vetëm për ata.

Ky opinion shpreh një mohim të dyfishtë për të drejtën e marrjes së shërbimeve publike për personat LGBT, e para sepse propogandon shërbime të veçuara për personat LGBT dhe e dyta sepse përpiket të justifikojë ngritjen e shërbimeve të specializuara për personat LGBT. Mohimi i parë që ka të bëjë me veçimin e personave LGBT nga të tjerët në marrjen e shërbimeve të përbashkëta me të gjithë qytetarët e tjerë përmban rrezikun e përjashtimit social dhe izolimit shoqëror të personave LGBT si persona me cilësi të veçanta, të ndryshëm nga shumica e popullsisë, duke justifikuar kështu denormalizimin e tyre ose të qenët ndryshe nga njerëzit normalë. Ndërsa mohimi i dytë, i marrjes së shërbimeve të specializuara dhe jo të përbashkëta përmban dy rreze: e para sepse krijon premisat për ngritjen e një sistemi shërbimesh speciale për personat LGBT, gjë që mund të ndikojë në justifikimin e filozofisë eugeniste për pakicat, përfshi edhe bashkësinë e personave LGBT, si teprica shoqërore që nuk meritojnë kujdes shoqëror bashkë me të tjerët, pra justifikon devalorizimin shoqëror të personave LGBT si grup që vlen më pak se shumica, dhe e dyta ushqen politikat institucionalizuese për personat LGBT si të vetmen formë përkujdesi shoqëror duke u mohuar personave LGBT jetesën në bashkësi me të tjerët dhe futjen e tyre në institucione rezidenciale të specializuara me qëllim korrektimi.

Institucionalizimi si formë e përkujdesjes shoqërore ka dështuar të tregojë se ka mundur të korrektojë dhe ca më pak të integrojë shoqërisht personat e institucionalizuar. Përvoja 100-

vjeçare e institucionalizimit të personave me aftësi të kufizuara ka treguar se institucionalizimi shkaktoi dëme të parikthyeshme psikologjike dhe shoqërore për të institucionalizuarit. Praktika institucionalizuese jo vetëm që nuk është rehabilituese dhe integruuese, por përkundrazi ngjan shumë me praktikën penitenciare të ndëshkimit të veprave devijante nga personat e vendosur në rregjimin e burgjeve. Institucionalizimi i shërbimeve publike për personat LGBT do të shkaktoje jo vetëm veçim të tyre nga të tjerët në marrjen e shërbimeve, por edhe justifikim të qëndrimeve diskriminuese ndaj tyre. Veçimi do shkaktojë izolimin e tyre dhe ofrimin e shërbimit veç të tjerëve si mënyrë korrektimi për sjelljen, ndjesitë dhe zgjedhjet personale që janë të ndryshme prej shumicës. Si përfundim, institucionalizimi ose marrja e shërbimeve të specializuara veç të tjerëve është një shkelje serioze e të drejtës themelore të personave LGBT për shërbime publike të përbashkëta.

Marrja e shërbimeve të veçuara për personat LGBT



Për të eksploruar me tej arsyen që i ka shtyrë një pjesë të të anketuarve të shprehin se personat LGBT duhet të marrin shërbime veç të tjerëve, ata janë pyetur se në të mirë të kujt është kjo? Kjo pyetje u bë për të gjithë të anketuarit edhe për ata që u përgjigjën se do t'i ofronin vetë shërbime personave LGBT pa i referuar tek shërbimet e tjera. Qëllimi i pyetjes ishte të mësonte se çfarë opinioni kishin të anketuarit në lidhje me tipologjinë e shërbimeve që duhet të marrin personat LGBT: shërbime të përbashkëta apo të veçuara? Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, 38.4 për qind nuk shohin ndonjë dobi specifike tek shërbimet e veçuara. Ata shprehin se marrja e shërbimeve veç të tjerëve nuk është në dobi të askujt. Kjo pjesë i përket atyre të anketuarve që mendojnë se personat LGBT duhet të marrin shërbime të përbashkëta me të tjerët.

Kur pyeten në lidhje me shërbimet e veçuara të specializuara të destinuara vetëm për personat LGBT përqindja e të anketuarve që mendojnë se shërbimet duhet të jenë të njëjta (88.8 për qind) gati përgjysmohet (50.4 për qind) kur ripyeten për të rikonfirmuar ose rishikuar këtë opinion. Përgjysmimi i mbështetësve të shërbimeve të përbashkëta është

shumë problematik, pasi konfirmon pozitën e lëkundur të punonjësve në lidhje me formën e shërbimit më të përshtatshëm për personat LGBT. Mbase, nisur nga synime të mira për t'u ardhur sa më mirë në ndihmë nevojave të personave LGBT me shërbime të përshtatura kërkesave të tyre, kjo pjesë e të anketuarve edhe pse në fillim mbështet marrjen e shërbimeve të përbashkëta (88.8 për qind), kur ripyeten se cila formë shërbimi mund të jetë më e dobishme për personat LGBT, shërbimi i përbashkët apo i veçuar, rreth gjysma e tyre, 50.4 për qind nuk janë më edhe aq të sigurtë. Vetëm 38.4 për qind rikonfirmojnë qëndrimin e mëparshëm se personat LGBT duhet të marrin të njëjtat shërbime me të tjerët. Hezitimi i shumicës së të anketuarve se cila formë shërbimi është më dobiprurëse për personat LGBT tregon qartë nevojën për informim dhe edukim të punonjësve vendore mbi të mirat që ka shërbimi i përbashkët dhe të metat që paraqet shërbimi i veçuar, nën këndvështrimin e të drejtave të njeriut, vlerave dhe drejtësisë sociale.

Duke mos pasur njohje me personat LGBT, pjesa më e madhe e punonjësve përdorin si burim informacioni opinionet e të tjerëve dhe mitet paragjyquese që rrethojnë homoseksualitetin si një dukuri e çuditshme dhe sjellje jotipike seksuale. Madje, një pjesë prej tyre mund edhe të besojnë mitin e përhapur gjerësisht se personat LGBT kanë diçka që nuk shkon me shëndetin e tyre, janë difektozë e për pasojë duhen kuruar, për të gjetur shërim për dëmtimin që kanë. Pra personat LGBT duhet të jenë subjekt i trajtimit mjekësor dhe këshillimit klinik psikologjik për të ndrequr keqformimin seksual në planin fiziologjik dhe shpirtëror. Atyre duhet t'u ofrohet këshillim psiko-mjekësor në mënyrë që të normalizohen nga pikpamja biologjike dhe psikologjike, pra të bëhen heteroseksualë. Punonjësit mendojnë se duke mos qenë të informuar mbi homoseksualitetin janë edhe të pakualifikuar t'u ofrojnë shërbime efikase personave LGBT.

Mbështetja e punonjësve tek stereotipet paragjyquese për homoseksualitetin dhe mosballafaqimi i këtyre stereotipeve përmes njohjes me persona LGBT bën që një e katërta e tyre, 25.0 për qind, të besojnë se do të ishte në të mirë të personave LGBT që ata të merrnin shërbime veç të tjerëve. Ky opinion, i mbuluar me velin e përkujdesjes duket sikur është në favor të interesit të personave LGBT sepse përcjell idenë se nëse personat LGBT do të marrin shërbime veç të tjerëve, nga njëra anë do të përfitojnë prej një shërbimi të specializuar të kualifikuar, dhe nga ana tjetër do të marrin shërbim në një mjedis të mbrojtur prej specialistëve më pak paragjyqes. Kjo pjesë e punonjësve, që mendon se veçimi i personave LGBT nga të tjerët në marrjen e shërbimeve publike është në të mirë të tyre ka nevojë për trajnim në fushën e të drejtave të personave LGBT si qytetarë me të drejta të plota me të tjerët. Ata kanë gjithashtu nevojë për informim për format e seksualitetit njerëzor për të çmitizuar dhe demistifikuar homoseksualitetin si devijancë morale dhe si sëmundje.


Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 20.5 për qind shprehen se marrja e shërbimeve publike nga personat LGBT veç të tjerëve është në të mirë të të gjithëve, pra të vetë personave LGBT dhe të qytetarëve të tjerë. Kjo pjesë e punonjësve mbartin një paragjykim të fortë homofob, ata përveçse i shohin personat LGBT si deviantë, i konsiderojnë edhe si rrezik moral, si persona që mund të ndikojnë për keq tek të tjerët, duke i "kontaminuar" me shturjen e tyre seksuale. Për këtë arsye, ata mendojnë se është absolutisht më mirë që personat LGBT të marrin shërbime veç, kjo jo vetëm në të mirë të tyre por edhe të shoqërisë, e cila duhet ruajtur nga ndikimi negativ që mund të kenë

personat LGBT tek të tjerët nëse përzihen dhe trajtohen njësoj si të tjerët. Këtij grupi punonjësish i shtohet edhe një përqindje e vogël të anketuarish, 3.1 për qind, që mendojnë se është sidomos në të mirë të të tjerëve që personat LGBT të mbahen veç të tjerëve dhe të mos përzihen me ta në hapësirën publike ku edhe ofrohet shërbimi publik. Pra sipas tyre, personat LGBT duhet të mbahen në hije dhe të mos kenë dukshmëri publike, për të ruajtur të pastër moralin e shoqërisë. Shfaqja e qëndrimeve të tilla homofobe cënon rëndë dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të personave LGBT si qytetarë. Qëndrime të tilla, të shprehura nën petkun e ndjeshmërisë morale publike, nxisin frymën e urrejtjes dhe justifikojnë praktikën përjashtuese dhe diskriminuese kundër personave LGBT. Trajnimi për të drejtat e personave LGBT është një domosdoshmëri për këtë grup punonjësish në mënyrë që ata të ndryshojnë qëndrimet ndaj personave LGBT dhe t'i trajtojnë me respekt si të gjithë qytetarët të cilëve u shërbejnë.

Rreth 13.0 për qind e të anketuarve nuk kanë një përgjigje të saktë se çfarë lloj shërbimesh janë më të dobishme për personat LGBT, shërbimet e përbashkëta apo të veçuara. Ata nuk dinë të thonë se në të mirë të kujt do të ishte dhënia e shërbimit veç të tjerëve për personat LGBT. Mosmbajtja e një qëndrimi të përcaktuar në lidhje me këtë opinion shpreh nevojën e këtij grupi punonjësish për trajnim në fushën e të drejtave të personave LGBT për shërbimet publike të ofruara nga bashkia.

Gadishmëria e punonjësve për të ofruar shërbimet, sipas rretheve

Në lidhje me qëndrimet e punonjësve për t'u shërbyer personave LGBT është bërë edhe analiza e të dhënave demografike sipas përkatësisë gjeografike dhe afiliacionit profesional të punonjësve bashkiakë. Kjo analizë nxjerr në pah nivelin e homofobisë së punonjësve sipas rretheve dhe synon të projektojë një tablo të qëndrime miqsore dhe armiqësore ndaj personave LGBT si përfitues të shërbimit publik në bashki.




Nga të dhënat rezulton se më miqësor është mjedisi i shërbimeve të bashkisë Korçë, punonjësit e së cilës janë shprehur që të gjithë se nëse në zyrën e tyre do të shkonte një person LGBT ata do t'i ofronin vetë shërbim pa i referuar në zyra të tjera. Pas Korçës, mjedisin më miqësor e ofron bashkia e Shkodrës, 92.7 për qind e punonjësve të së cilës shprehen se do t'i ofronin vetë shërbime personave LGBT dhe pas saj vjen bashkia e

Elbasanit, me 90.6 për qind të punonjësve që shprehen se do t'i ofronin shërbim personave LGBT pa i deleguar tek zyrat e tjera. Krahasuar me Korçën, Shkodrën dhe Elbasanin, bashkitë Durrës, Vlorë dhe Tiranë ofrojnë një mjedis më pak miqësor për personat LGBT. Punonjësit e bashkisë së Durrësit janë shprehur në një përqindje të konsiderueshme, rreth 42.3 për qind, se do t'i referonin personat LGBT diku tjetër për shërbim. Punonjësit e bashkisë Durrës janë shprehur se kanë edhe përqindjen më të lartë të njohjeve me personat LGBT, 61.5 për qind, krahasuar me punonjësit e bashkive të tjera. Është paradoks që ata që kanë më shumë njohje me personat LGBT janë edhe më shumë homofobë! Mbase ata që kanë njohje, që zenë 61.5 për qind të punonjësve në Durrës janë edhe ata që do t'i ofronin shërbim (57.7 për qind), ndërsa ta që nuk kanë njohje (38.5 për qind) bien në kategorinë e atyre që do t'i refuzonin ose do t'i delegonin tek shërbimet e tjera.

Qytetet me flukset më të mëdha migratore të brendshme, Tirana, Durrësi dhe Vlora kanë një përzierje nënkulturash dhe rritje të shkallës së paragjyqimeve të ndërjellta me sfond krahinor. Qytetet që kanë pritur migrantë të brendshëm nuk kanë pësuar ndonjë përparim të madh ndaj hapjes kulturore, përkundrazi, të ardhurit nga zonat e thella kryesisht malore dhe kodrinore kanë sjellë me vete profilet psiko-kulturore të nënkulturave të tyre duke ruralizuar tablonë kulturore të qendrave urbane, në vend që të urbanizoheshin prej kontaktit me banorët e qyteteve. Për shkak të ruralizimit të qyteteve dhe ndikimit të normave kulturore tradicionale që ruhen me konservatorizëm sidomos nga të ardhurit, është e shpjegueshme se përse bashkitë e qyteteve pritëse të migrantëve të brendshëm shpërfaqin një mjedis më pak miqësor se sa bashkitë e qyteteve që kanë pritur më pak migrantë nga zonat rurale. Qytetet e mëdha, me përzierje të konsiderueshme nënkulturash rurale, paraqesin një sfidë të vështirë për projektin e respektimit të të drejtave të personave LGBT që në rradhë të parë kërkon një hapje kulturore dhe zbutje të konservatorizmit tradicional kulturor. Punonjësit e bashkive Tiranë, Durrës dhe Vlorë janë më nevojtarët për trajnime në fushën e të drejtave të personave LGBT, sidomos në lidhje me marrjen e shërbimeve publike të përbashkëta.

Gadishmëria e punonjësve sipas moshës




qëndrimeve homofobe tek punonjësit.

Punonjësit më pak homofobë janë të rinjtë e moshës 19-29 vjeç, që përfaqësojnë 90.0 për qind. Përqindja e lartë e të anktuarve në moshë të re që tregohen korrektë në ofrimin e shërbimeve vendore ndaj personave LGBT është një tregues shumë pozitiv për ndryshimin e

Më homofobe paraqitet grup-mosha 40-49 vjeç, tek e cila thuajse një në tre punonjës nuk do tregohej i gatshëm për t'i shërbyer një personi LGBT, por do ta refuzonte ose do ta referonte për shërbim tjetërkund. Fakti që homofobia shënon zbehje në moshat më të reja, tregon se përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit kanë ndodhur ndryshime pozitive në mendësitë e publikut në lidhje me të drejtat e njeriut dhe me dukurinë e homoseksualitetit si një formë e seksualitetit njerëzor. Ndryshimet janë pasojë e difuzionit kulturor, kryesisht ndikimit të kulturës perëndimore që tregon ndjeshmëri ndaj përkatësisë gjinore dhe zgjedhjeve individuale si të drejta themelore. Ndikim ka edhe puna sensibilizuese për të drejtat e njeriut e bërë nga organizata të shoqërisë civile dhe nga sistemi arsimor që ka përfshirë në programin mësimor të drejtat e njeriut dhe të respektit të njerëzve pavarësisht dallimeve. Për të drejtat e personave LGBT një rol të veçantë kanë luajtur organizatat përfaqësuese të tyre në vend, si dhe kontaktet me natyrë informuese dhe ndërgjegjësuere në shkolla të mesme dhe universitete.

Mosha mbi 30 vjeç paraqet një nivel më të lartë homofobie, pasi është prekur më pak prej edukimit qytetar me në qendër të drejtat e njeriut dhe mbart më shumë koncepte të kulturës tradicionale në ndërgjegje. Meqë punonjësit mbi 30 vjeç përbëjnë rreth 70.0 për qind të administratës vendore, lipset të merret një fushatë informuese dhe trajnime formuese për të drejtat e personave LGBT, në mënyrë që këtyre të mos u mohohet shërbimi nga administrata vendore.

Gadishmëria e punonjësve sipas formimit Universitar



Formimi universitar është një tjetër variabël që është analizuar në korelacion me qëndrimet ndaj shërbimeve. Siç shihet edhe nga të dhënat e kërkimit, punonjësit e bashkive nuk dallojnë shumë në qëndrimet e tyre për gadishmërinë për t'u shërbyer personave LGBT sipas përkatësisë së degës së formimit universitar. Pavarësisht formimit

profesional përqindjet e punonjësve që do të ofrojnë versus atyre që nuk do të ofrojnë vetë shërbime janë të ngjashme dhe variojnë në raportet 20 – 30 për qind për ata që do t'i referojnë tek të tjerët, dhe 70 – 80 për qind për ata që do t'u shërbejnë vetë. Opinionet e shprehura sipas përkatësisë së formimit universitar duhen marrë me një dozë rezerve, pasi kamponi nuk është shumë i balancuar, sepse shumicën e të anketuarve e përbëjnë të dilpomuarit në shkenca sociale dhe ekonomik, të cilët përbëjnë edhe shumicën e punonjësve të bashkive. Ndërsa profesionet e tjera si: inxhinieri, mjekësi dhe arkitekturë zenë një përqindje të vogël të të punësuarve në bashki. Punonjësit me formim shoqëror,

ekonomik, juridik dhe pedagogjik përbëjnë edhe personelin që është në kontakt të drejtëpërdrejtë me qytetarët që kërkojnë shërbime nga bashkia. Opinioni i tyre është shumë relevant për kërkimin, pasi ajo çka synohet të eksplorohet përmes kërkimit është pikërsiht se sa miqësorë janë me personat LGBT ata punonjës bashkie që ofrojnë shërbime për ta.

Kështu për shembull, rezulton se mjekët dhe arkitektët janë më miqësorë në dhënien e shërbimeve ndaj personave LGBT, krahasuar me profesionistët e tjerë, por mjekë dhe arkitektë në kampion janë vetëm 6 vetë përkatësisht, ndërkohë që numri i të anketuarve është 224.


TABELA 3: Gadishmëria për të ofruar shërbime sipas gjinisë dhe formimit

Fusha e studimit	Nëse në zyrën tuaj vjen një person LGBT:					Gjithsej
	<i>Do t'i ofroni shërbim</i>	<i>Do të refuzoni t'i shërbeni</i>	<i>Do ta referoni për shërbim diku tjetër</i>	<i>Tjetër</i>	<i>Missing</i>	
Arkitekture	5	0	0	0	0	5
Ekonomik	56	3	5	1	2	66
Inxhinieri	15	3	1	0	0	19
Juridik	25	1	3	1	2	31
Mesuesi	22	1	3	0	2	28
Mjekësi ose infermieri	2	0	0	0	1	3
Nuk jepet informacion	17	1	2	0	2	22
Sociologji ose Psikologji	34	1	5	1	1	42
Tjetër	4	1	1	0	0	6
FEMRA						
Arkitekture	3	0	0	0	0	3
Ekonomik	42	1	5	1	0	49
Inxhinieri	10	1	0	0	0	11
Juridik	19	1	2	1	1	24
Mesuesi	17	1	3	0	1	22
Mjekësi ose infermieri	2	0	0	0	1	3
Nuk jepet informacion	14	0	1	0	1	16
Sociologji ose Psikologji	31	1	5	1	1	39
Tjetër	4	1	1	0	0	6
MESHKUJ						
Arkitekture	2	0	0	0	0	2
Ekonomik	13	2	0	0	2	17
Inxhinieri	5	2	1	0	0	8
Juridik	5	0	1	0	1	7
Mesuesi	5	0	0	0	1	6
Mjekësi ose	0	0	0	0	0	0

infirmieri						
Nuk jepet informacion	2	1	1	0	1	6
Sociologji ose Psikologji	3	0	0	0	0	3
Tjetër	0	0	0	0	0	0


Është me interes të shihet rezultati i kombinuar i variablave gjinorë dhe arsimorë me gadishmërinë për t'u shërbyer personave LGBT. Sikurse pohohet edhe në literaturën për studimet gjinore, përgjithësisht vajzat dhe gratë janë më pak homofobe se sa djemtë dhe burrat. Krahasimi mes meshkujve dhe femrave me formim nga shkencat sociale duhet marrë me rezervë, pasi janë vetëm tre meshkujt e përfaqësuar në kërkim, përkundër 39 femrave. Krahasimet e tjera janë më të vlefshme pasi kampioni paraqet më shumë mundësi për krahasim gjinor brenda një grupi profesionistësh.

Nëse në zyrën tuaj vjen një person LGBT: femrat



Përqindja e të anketuarve që nuk japin informacion për formimin e tyre universitar është më e lartë tek femrat se sa tek meshkujt. Nuk deklarojnë formimin universitar 16 punonjëse dhe 6 punonjës. Ndërsa të tjerët e kanë deklaruar formimin universitar. Është me interes të shihet në këtë grup se femrat janë më të gatshme të ofrojnë shërbim se sa meshkujt për personat LGBT, me përkatësisht 81.8 përkundërt 40 për qind. Pra femrat në këtë nëngrup janë dy herë më të gatshme se meshkujt të ofrojnë shërbime për personat LGBT. Në këtë nëngrup bëjnë pjesë edhe të punësuarit pa shkollë të lartë në bashki, që kryejnë funksione të shërbimit të brendshëm dhe mirëmbajtjes për nevojat operationale të bashkisë, si punonjës pastrimi, sigurimi, shoferë, roje, etj. Megjithatë, edhe tek të shkolluarit me arsim të mesëm, vihet re se punonjësit femra janë më tolerante ndaj personave LGBT se sa punonjësit meshkuj.

Nëse në zyrën tuaj vjen një person LGBT: meshkujt




Dallime gjinore vihen re edhe tek punonjësit e nënthurpeve të tjera profesionale. Tek profesionet inxhinieri, juridik dhe ekonomik vihet re qartë se punonjëset vajza dhe gra janë më të gatshme se sa burrat të ofrojnë vetë shërbime për personat LGBT. Ndër inxhinierët, janë vetëm 9 për qind femrat që thonë se nëse në zyrën e tyre do të paraqitej për shërbim një person LGBT do ta referonin në një shërbim tjetër, ndërsa tek burrat përqindja e atyre që do t'i refuzonin shërbim ose do t'i dërgonin tek zyrat e tjera është shumë më e lartë, 37.5 për qind. Nga të dhënat duket se inxhinierët janë më homofobë se sa inxhinieret. Tek nëngrupi i juristëve, gjithashtu femrat janë më miqësore se sa meshkujt. Shprehen se do t'i dërgojnë për shërbim tjetërkund 20.8 për qind e juristeve gra dhe 28.6 për qind e juristëve burra. Pra burrat juristë janë dukshëm më refuzues se sa gratë juriste, megjithëse janë më të pakët në numër si punonjës krahasuar me femrat jurist (m=7/f=24). E njëjta gjë vihet re edhe tek nëngrupi ekonomistëve. Janë shprehur se do t'i dërgojnë tek shërbime të tjera 14.3 për qind e ekonomisteve gra, ndërsa ekonomistë burra që shprehen se nuk do t'u shërbenin vetë personave LGBT janë 23.5 për qind e tyre. Këto të dhëna konfirmojnë nevojën e madhe që kanë punonjësit meshkuj të bashkive për trajnim në fushën e të drejtave të njeriut për të sfiduar homofobinë dhe qëndrimet diskriminuese që rrjedhin prej saj.

Gadishmëria e punonjësve sipas përkatësisë fetare

Një tjetër e dhënë me rëndësi për analizën kërkimore është edhe korrelacioni i gadishmërisë për të shërbyer me përkatësinë fetare dhe shkallën e besnikërisë regjigjioze të shprehur përmes praktikimit të ritualeve fetare. Nga të dhënat e kërkimit rezulton se më shumë se gjysma, 53.5 për qind e punonjësve të anketuar të gjashtë bashkive, janë të përkatësisë fetare myslimane. Kjo e dhënë korrespondon edhe me të dhënat e INSTAT për regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, sipas të cilit popullsia me përkatësi myslimane ishte 56.7 për qind (INSTAT, 2011). Rreth 37.6 janë të përkatësisë fetare të krishterë, ndërsa afërsisht 9 për qind deklarojnë se janë agnostikë dhe ateistë, e dhënë e përputhshme me të dhënat zyrtare sipas së cilave rreth 9 për qind e popullsisë janë besimtarë të pacilësuar (agnostikë) dhe ateistë (po aty).


Shërbimet që duhet të marrin personat LGBT duhet të jenë



Megjithëse deklarojnë përkatësinë fetare, të anketuarit e referojnë atë si përkatësi kryesisht të trashëguar prej familjes dhe jo prej zgjedhjes personale. Këtë gjë e konfirmon edhe fakti se shumica prej tyre, 87.5 për qind deklarojnë se nuk i frekuentojnë institucionet fetare, kishat dhe xhamitë. Ndër punonjësit, më tolerantët janë ata të besimit protestant, por këta janë një përqindje shumë e vogël, 1.8 për qind e të anketuarve, përqindje që korrespondon edhe me përqindjen e besimtarëve të përkatësisë së krishterë protestante ose ndjekës të kishës evangjeliste. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, ungjillorët përbënin 0.14 për qind të besimtarëve. Pas protestantëve, më tolerantë dhe të gatshëm për t'u ofruar shërbim personave LGBT rezultojnë besimtarët e ritit të krishterë katolik roman, me 96 për qind të gatshëm. Punonjësit me përkatësi myslimane suni janë përgjithësisht të gatshëm, 91 për qind, t'u shërbejnë vetë personave LGBT. Disi më refraktarë paraqiten punonjësit me përkatësi ortodokse ose të krishterë të ritit bizantin (16.4 për qind), myslimanët e sektit bektashi (15 për qind) dhe agnostikët (15 për qind), të cilët shprehen se do t'i drejtonin personat LGBT për shërbime tek zyrat e tjera.

Shërbimet e kërkuara nga personat LGBT pranë njesive të pushtetit vendor


Rreth 30 për qind e të anketuarve shprehen se personat LGBT kanë kërkuar shërbime në bashki si: punësim, strehim, ndihmë ekonomike, etj, ndërsa rreth 70 për qind shprehen se nuk kanë ofruar shërbim për ndonjë person LGBT. Kjo përqindje korrespondon me përqindjen e atyre që nuk kanë njohje me personat LGBT, pra është i njejti grup të anketuarish që përgjigjet se nuk ka njohje dhe nuk ka ofruar shërbime për personat LGBT.



Mosnjohja me personat LGBT bën që dy të tretat e punonjësve të bashkive të shprehen se nuk kanë pasur mundësi të ofrojnë shërbime për personat LGBT.


Grup-mosha e personave LGBT që kanë kërkuar shërbime në bashki

Sipas të anketuarve, grupmosha që ka kërkuar më shumë shërbime në bashki është 25-35 vjeç, moshë kjo që korrespondon me nevojat e individit të rritur për strehim, punësim dhe mbrojtje sociale. Përqindja e personave LGBT që kërkojnë shërbime në bashki bie pas moshës 40 vjeç pasi personat LGBT sikurse shumica e të rriturve të grupmoshës 40 vjeç e lart mund të jenë aktivë në tregun e punës dhe të kenë një jetë të stabilizuar sociale dhe ekonomike. Gjithësesi, rreth 67 përqind e të anketuarve shprehen se asnjë person LGBT nuk është ofruar për të marrë shërbime prej tyre.



Mbrojtja e privatësisë së personave LGBT

Në lidhje me mbrojtjen e privatësisë së personave LGBT, pjesa më e madhe e të anketuarve, 81 përqind shprehen se nuk e dinë nëse privatësia e tyre ruhet apo jo nga ana e stafit vendor.




Kjo përqindje e lartë hezitimi tregon se sa të pambrojtur janë personat LGBT në privatisinë e tyre nga ana e shërbimit publik vendor. Të dhënat e tyre personale dhe identiteti i tyre gjinor mund të jenë objekt diskutimi, komentesh denigruese dhe mund t'i ekspozojnë ata ndaj praktikave diskriminuese për shkak të orientimit seksual. Përqindja e lartë e të anketuarve të pasigurtë rreth mbrojtjes së privatisisë së personave LGBT tregon nevojën e madhe që ka personeli i bashkive për trajnim në fushën e ruajtjes së privatisisë së të dhënave të personave LGBT dhe personave të tjerë që ndodhen në pozita të pafavorshme sociale.

Trajtimi i diferencuar i transgjitorëve ndaj LGBT

Në lidhje me trajtimin e diferencuar mes personave transgjitorë dhe homoseksualëve dhe biseksualëve, shumica e të anketuarve rreth 57 për qind nuk dinë se si të përgjigjen, a diferencohen apo jo transgjitorët në shërbimet që marrin nga bashkia prej homoseksualëve dhe biseksualëve. Kjo vjen nga mosdallimi i transgjitorëve nga homoseksualët dhe biseksualët. Ndërsa rreth një e katërta e të anketuarve shprehen se transgjitorët nuk diferencohen fare nga homoseksualët dhe biseksualët, gje që konfirmon edhe rezultatin e mësipërm për paaftësinë e punonjësve të dallojnë nënkategoritë e grupit të personave LGBT.

Trajtim i diferencuar i transgjitorëve nga LGB




Vetëm 19 për qind e të anketuarve janë shprehur se personat transgjitorë marrin trajtim të diferencuar nga personat LGB. Me këtë pohim nuk është e qartë nëse të anketuarit kanë

dashur të thonë se janë në gjendje të dallojnë transgjinatorët nga personat LGB apo transgjinatorët diferencohen prej personave LGB në marrjen e shërbimeve, për shkak se transgjinatorët mund të jenë më të dukshëm se sa LGB si homoseksualë të deklaruar.

Sistem referimit për personat LGBT


Pjesa më e madhe e të anketuarve rreth 57.5 për qind shprehen se nuk ekziston ose se ata nuk dinë se egziston një system referimi për nevojat specifike të personave LGBT në bashki.



Ndërsa pjesa tjetër mendojnë se bashkia ka një sistem referues shërbimesh për personat LGBT si për të gjithë personat e tjerë që kërkojnë shërbime pranë bashkisë. Shërbimet në të cilat referohen më së shumti qytetarët në nevojë, përfshirë edhe personat LGBT, sipas të anketuarve janë shërbimi i këshillimit, shërbimi shëndetësor, ndërgjegjësimi dhe informimi për të drejtat e tyre si dhe mbrojtja nga diskriminimi.

5.4 Njohja me personat LGBT

Njohjet me persona LGBT



Shumica e punonjësve të anketuar, rreth 64 për qind pohojnë se nuk kanë njohje me personat LGBT. Vetëm 36 për qind deklarojnë se kanë njohur persona LGBT.


Shkalla e ulët e njohjes me personat LGBT bën që punonjësit të mos kenë informacion dhe të mbështeten tek stereotipet negative gjinore që portretizojnë

me tone denigruese personat LGBT. Opinionet e të anketuarve mbështeteten tek keqperceptimi për personat LGBT si individë deviantë që kanë nevojë për korrigjime trupore dhe sjellore. Në mënyrë që punonjësit bashkiakë të ndryshojnë perceptimet e tyre dhe qëndrimet ndaj personave LGBT, njohja me personat LGBT dhe me të drejtat e tyre është një nevojë parësore dhe detyrë për organizatat e të drejtave të personave LGBTI.

Njohjet me personat LGBT sipas rretheve

Nga të dhënat e studimit, rezulton se punonjësit që kanë pasur më shumë njohje me personat LGBT janë punonjësit e bashkisë së Durrësit, 61.5 për qind, të pasuar nga ata të Elbasanit me 43.8 për qind dhe të Korçës me 39.1 për qind. Ndërsa punonjësit e bashkive Tiranë, Vlorë dhe Shkodër kanë më pak njohje me personat LGBT. Në bashkitë Korçë, Tiranë dhe Vlorë ka edhe punonjës që nuk janë të sigurtë nëse personat që atyre mund t'u jenë dukur si LGBT mund të kenë qenë vërtetë të tillë, pra nuk janë të sigurtë nëse kanë njohur vërtetë ndonjë prej tyre.

A keni pasur njohje më ndonjë person LGBT?




Përqindjen më të lartë të mosnjohjes së personave LGBT e zenë punonjësit e bashkisë Shkodër, ndër të cilët 75.6 për qind shprehen se nuk kanë njohur ndonjë person LGBT. Megjithatë kanë më pak njohje me personat LGBT, punonjësit e Shkodrës janë shprehur më të gatshëm, 92.7 për qind e tyre, për t'u shërbyer personave LGBT, krahasuar me punonjësit e bashkisë Durrës, të cilët edhe pse kanë më shumë njohje janë shprehur më pak të gatshëm, 57.7 për qind e tyre, për t'u shërbyer personave LGBT. Kjo diskordancë mes nivelit të njohjeve dhe qëndrimeve homofobe lipset të mbushet me informacion dhe edukim rreth të drejtave të personave LGBT.

Rrethanat e njohjes me personat LGBT

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve që kanë njohje me personat LGBT, rreth 41.2 për qind janë njohur me ta në rrethana miqësore dhe familjare, ndërsa 42.3 për qind janë njohur nëpërmjet punës. Një pjesë e të anketuarve, 16.5 për qind kanë deklaruar se i kanë njohur personat LGBT në rrethana të tjera, të ndryshme nga rrethi familjar, miqësor dhe marrëdhëniet e punës. Me siguri ata nuk kanë dashur të shprehen se i kanë pasur njohjet pikërisht në këto mjedise, familjare dhe miqësore, prandaj nuk kanë dashur ta tregojnë


mënyrën se si janë njohur. Pra nëse do të merrej si e mirëqenë se 16.5 për qind e të anketuarve kanë pasur njohje personale në rrethin familjar dhe miqësor atëherë përqindja e të anketuarve që i kanë njohur personat LGBT jashtë marrëdhënies së punës rritet, në 57.7 për qind.



Nga të dhënat nuk mund të inferohet me saktësi nëse njohja me personat LGBT ka ndikim pozitiv në zbutjen e qëndrimeve homofobe të të anketuarve, megjithëse duhej të ndodhte kështu, për shkak se njohja e drejtëpërdrejtë mund të demistifikojë mjegullën me të cilën është mbështjellë homoseksualiteti. Kontaktet me personat LGBT mund të kenë shërbyer si pikënisje për të hedhur poshtë paragjykimet për personat LGBT dhe për të iniciuar një marrëdhënie miqësore me ta.


Kontaktet me personat LGBT

Shumica e të anketuarve, rreth 60 për qind, deklarojnë se nuk kanë pasur asnjëherë kontakte me personat LGBT, ndërsa rreth 40 për qind kanë mundur të bisedojnë më një person LGBT gjatë harkut kohor të një viti. Fakti të anketuarit që kanë njohje me personat LGBT kanë mundur të bisedojnë me ta të paktën një herë brenda një vitit është një tregues pozitiv për krijimin e marrëdhënieve miqësore mes tyre.



Përmes bisedave me persona LGBT, punonjësit kanë mundësi të çmontojnë skematizimet paragjyquese që i kanë huazuar të gatshme nga korniza moralizuese e kulturës patriarkale dhe të krijojnë opinione të vetat, pa ndikime të jashtme. Nëpërmjet bisedave me personat LGBT, punonjësit kanë mundësi, gjithashtu, të konstatojnë se personat LGBT janë njerëz në rradhë të parë dhe kanë më shumë gjëra të përbashkëta se sa të kundërta me njerëzit e tjerë përfshirë edhe principet morale dhe vlerat universale kulturore.

Burimet e informacionit për personat dhe çështjen LGBT



Përveç njohjeve personale, të anketuarit shprehën se kanë marrë informacion për personat LGBT edhe në rrugë të tjera si nga interneti, literatura, studimet universitare, trajnimet dhe fushatat ndërgjegjësuese për të drejtat e njeriut, etj.

Gjithsesi, pjesa më e madhe janë vetëinformuar përmes internetit dhe nuk kanë marrë informacion dhe trajnim të strukturuar për çështje që lidhen me personat LGBT. Siç duket edhe nga grafiku, vetëm 15.2 përqind e të anketuarve kanë marrë trajnime për të drejtat e personave LGBT dhe pothuajse po aq janë informuar nga OJF-të për këto çështje. Mungesa e trajnimeve shpjegon edhe mbajtjen e qëndrimeve homofobe të administratës vendore ndaj personave LGBT. Sikurse pohojnë edhe të dhënat, trajnimi i punonjësve të bashkive për të drejtat e personave LGBT është një emergjencë profesionale që do t'u shërbejë atyre për të ofruar shërbim më cilësor ndaj qytetarëve LGBT dhe gjithëtë tjerëve.

Sikurse rezulton nga të dhënat, përqindja e atyre që kanë njohje të drejtëpërdrejtë është relativisht e vogël, por ka shumë rëndësi në vendosjen e marrëdhënieve shoqërore dhe miqësore mes punonjësve dhe personave LGBT. Prandaj, njohja e punonjësve me personat LGBT dhe organizatat për mbrojtjen e të drejtave të tyre është një domosdoshmëri. Me interes është edhe e dhëna lidhur me informimin për të drejtat e personave LGBT në kuadër të të drejtave të njeriut në kurrikulën e studimeve në shkollë të lartë, sipas të cilës vetëm 14.3 përqind e të anketuarve janë ekspozuar gjatë formimit universitar me koncepte të të drejtave të personave LGBT. Ata mund të jenë të diplomuarit e shkencave sociale, në kurrikulën e studimit të të cilëve është përfshirë edhe dimensionin i të drejtave të grupeve të diskriminuara dhe të marginalizuara nga shumica. Studentët e shkencave sociale përgatiten si profesionistë të përfshirjes shoqërore për grupet e përjashtuara dhe si avokatë të të drejtave të njeriut. Është e udhës që programi për të drejtat e pakicave dhe grupeve shoqërore të përjashtuara shoqërisht të përfshihet edhe në profile të tjera të formimit universitar, pasi të gjitha profesionet kanë si qëllim madhor shërbimin human.

Mbështetje protestave dhe marshimeve për të drejtat e personave LGBT

Për të kuptuar se sa mbështetës janë në mënyrë aktive për të drejtat e personave LGBT, të anketuarit u pyetën nëse do t'i mbështesnin protestat dhe kërkesat publike të personave LGBT për të drejta dhe qytetari. Rreth 30 për qind e të anketuarve shprehen se do t'i mbështesnin përpjekjet e personave LGBT për të drejta, ndërsa rreth 20 për qind shprehen se do t'i kundërshtojnë dhe do t'u kundërvihen. Të anketuarit e painteresuar përbëjnë gjysmën e punonjësve bashkiakë. Pra siç shihet nga të dhënat, dy të tretat e punonjësve nuk do t'i mbështesnin protestat ose kërkesat e bëra publikisht të personave LGBT për të drejta.



Përqindja e lartë e mosinteresimit është tregues i një homofobie të fshehur nga gjysma e punonjësve të anketuar. Kjo e dhënë flet për nevojën urgjente për trajnim të punonjësve vendore për të drejtat legjitime të personave LGBT.

5.5 Opinionet dhe perceptimet e zyrtarëve vendorë për personat LGBT

TABELA 4: Opinionet kryesore në lidhje me të drejtat e personave LGBT?

Sa përputhet mendimi juaj me pohimet e mëposhtme për qëndrimin ndaj LGBT?	Shkalla e përputhshmërisë në %				
	Shumë	Disi	Pak	Aspak	Pa përgjigje
a- janë qytetarë si gjithë të tjerët	68.3	13.4	1.8	5.4	11.2
b- kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët	81.7	6.3	0.4	0.9	10.7
c- kanë të drejtë të punësohen në administratën publike	73.2	8.0	3.6	3.1	12.0
d- kanë të drejtë të frekuentojnë të njejtat mjedise shërbimi	79.0	6.3	0.9	1.3	12.5
e- kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat	80.8	4.9	0.4	1.8	12.0


f- kanë të drejtë të martohen	42.4	8.5	5.8	20.5	22.7
g- kanë të drejtë të krijojnë familje	33.9	11.6	4.0	25.4	25.0
h- janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje	55.8	16.5	1.3	5.8	20.6
i- janë më miqësorë se njerëzit e tjerë	28.6	17.0	5.4	14.7	24.4
j- duhet të gëzojnë më pak të drejta	10.3	4.0	4.9	58.9	21.9
k- janë më inferiorë se të tjerët	5.8	16.5	10.3	43.8	23.7

Përgjithësisht të anketuarit shprehen pozitivisht në lidhje me respektimin e të drejtave të personave LGBT. Midis 70-80 për qind e tyre mendojnë se personat LGBT janë si gjithë qytetarët e tjerë, kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët, kanë të drejtë të punësohen në administratën publike, kanë të drejtë të marrin shërbime publike në të njëjtat mjedise me qytetarët e tjerë dhe kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkellen të drejtat.

Ndërkohë që miratojnë pasjen e të drejtave në përgjithësi për personat LGBT, të anketuarit në mënyrë paradoksale nuk miratojnë dy të drejta themelore, atë të martesës dhe të krijimit të familjes, gjë që kundërshton opinionin e mëparshëm. Pra, të anketuarit nuk i miratojnë të drejtat themelore të personave LGBT për t'u martuar (57.5 për qind) dhe për të pasur familje (66 për qind). Përveç të drejtës së martesës dhe familjes, të anketuarit janë pozitivë për të drejtat e tjera themelore si ajo e arsimit dhe e punësimit.


Në lidhje me opinionin se a ndihen inferiorë apo jo personat LGBT për identitetin e tyre rreth gjysma, 55.5 për qind e të anketuarve janë të pasigurtë. Kjo tregon për një mosnjohje nga ana e tyre të personave LGBT dhe problemeve që këta hasin me procesin e vet-deklarimit të identitetit LGBT (procesi i coming-out). Një shkallë të lartë pasigurie, të anketuarit paraqesin edhe në lidhje me opinionin mbi sjelljen miqësore të personave LGBT. Shprehen se nuk e dinë nëse personat LGBT janë apo jo më miqësorë se të tjerët rreth 56.7 për qind e të anketuarve. Ky fakt konfirmon rezultatin e mësipërm, sipas të cilit, punonjësit vendorë nuk kanë shumë njohje me persona LGBT. Mospasja e kontakteve dhe e njohjeve me personat LGBT duket edhe në përgjigjet e pasigurta të dhëna nga të anketuarit për korrektësinë e sjelljes dhe marrëdhënieve të krijuara nga LGBT, pasi janë afërsisht 40 për qind ata që shprehen se nuk dinë të shprehen për këtë opinion.

Sa përputhet mendimi juaj me pohimet e mëposhtme për LGBT?



Personat LGBT janë qytetarë si gjithë të tjerët


Rreth dy të tretat e punonjësve të anketuar shprehen se personat LGBT janë si të gjithë qytetarët e tjerë, me të njëjtat të drejta dhe detyrime. Ndërsa, një e treta shprehen se nuk janë të bindur nëse personat LGBT janë si qytetarët e tjerë. Ky është një tregues shqetësues për nivelin e lartë të homofobisë së punonjësve vendore, pasi i bie që një ndër tre prej tyre të mbajë një qëndrim diskriminues ndaj personave LGBT dhe t'u refuzojë shërbimin publik.



Punonjësit që shfaqin qëndrime homofobe mund të kenë nevojë për më shumë informim dhe edukim për të drejtat e njeriut. Ata gjithashtu lipset të kuptojnë se orientimi seksual është një e drejtë njerëzore dhe se marrja e shërbimeve publike nga administrata vendore nuk mund të kushtëzohet me përkatësinë, pasi për administratën publike është detyrim ligjor t'u shërbejë të gjithë qytetarëve pa dallim.

Personat LGBT kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 82.0 për qind, shprehen se personat LGBT duhet të arsimohen bashkë me të tjerët në të njëjtat mjedise shkollore. Ndërsa pjesa tjetër, 17.0 për qind luhaten mes mosaprovimit dhe aprovimit për gëzimin e kësaj të drejte nga ana e personave LGBT.




E drejta për arsim është një e drejtë themelore kushtetuese dhe personat LGBT e gezojnë atë pa asnjë rezervë, por opinioni hezitues i rreth 18.0 për qind të punonjësve të administratës vendore paraqet një shqetësim real për ushtrimin e kësaj të drejte. Ky opinion është problematik, pasi pothuajse një në pesë punonjës mendon se personat LGBT duhen shkolluar veç të tjerëve, pra në një sistem arsimor të ndarë, sipas të cilit personat LGBT të veçohen në mjedise të posaçme shkollimi, me pretekstin se nuk janë si të tjerët. Në një kontekst ligjor që mbron mosdiskriminimin dhe gjithëpërfshirjen në arsim, pasja e këtij opinioni është një pengesë për gëzimin e të drejtës për arsim për personat LGBT. Trajnimi i administratës vendore në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është një domosdoshmëri parësore dhe emergjente.

Personat LGBT kanë të drejtë të punësohen në administratën publike


Përgjithësisht të anketuarit, 73.0 për qind, mendojnë se personat LGBT mund të punojnë në administratën publike, nëse posedojnë formimin arsimor dhe shprehitë profesionale përkatëse. Por, rreth 27.0 për qind e tyre janë të lëkundur përse i përket të drejtës së personave LGBT për t'u punësuar në administratën publike.

LGBT kanë të drejtë të punësohen në administratën publike



Përqindja e të lëkundurve përcjell nevojën e tyre për informim dhe trajnim në fushën e të drejtave të njeriut me fokus orientimin seksual. Përgjithësisht e drejta për punësim në administratën publike u mohohet personave në konflikt me ligjin për vepra të rënda penale. Duket sikur punonjësit që kundërshtojnë punësimin e personave LGBT në administratën publike vendosin shenjën e barazimit mes keqbërësve dhe personave LGBT. LGBT konsiderohen si persona që kanë devijuar nga standardi i moralit heteroseksual, prandaj një pjesë e të anketuarve besojnë se ata mund të mos jenë korrektë në marrëdhëniet e punës.

LGBT kanë të drejtë të frekuentojnë të njejtat mjedise shërbimi




Shumica e të anketuarve, rreth 80 përqind, shprehen se personat LGBT kanë të drejtë të frekuentojnë të njejtat mjedise shërbimi që frekuentojnë edhe të tjerët. Rreth 20 përqind janë të pavendosur nëse personat


LGBT duhet të marrin shërbime bashkë me të tjerët apo në mjedise të veçara. Pra një në pesë punonjës nuk është i qartë se ku duhet të marrin shërbime personat LGBT. Kjo pasiguri buron prej faktit se punonjësit nuk kanë informacion për personat LGBT dhe janë të ndikuar nga paragjykimet dhe mitet për homoseksualitetin. Është shumë e dukshme nevoja për informim dhe për trajnim në fushën e të drejtave të njeriut për personat LGBT dhe sidomos për të drejtën e personave LGBT për të marrë shërbime publike si të gjithë qytetarët.

Personat LGBT kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat

Përgjithësisht të anketuarit, 81.0 për qind, shprehen pozitivisht për të drejtën që personat LGBT kanë për t'u ankuar, në rast se shërbimi që marrin nuk është cilësor, në rast se shërbimi iu refuzohet si dhe në rastet kur u shkelen të drejtat. Rreth 20 për qind e punonjësve nuk janë shumë të sigurtë nëse personat LGBT e kanë apo jo këtë të drejtë.



Personat LGBT kanë të drejtë të martohen



Megjithëse nuk janë shumicë, por 42 për qind, të anketuarit që e mbështesin të drejtën e personave LGBT për të pasur familje janë një sinjal i mirë për ndryshimin e qëndrimeve homofobe në mendësitë e shoqërisë. Ata që shprehen në mënyrë kategorike kundra


martësës së personave LGBT janë sa gjysma e atyre që e miratojnë, pra 21 për qind.

Përqindja e atyre që nuk janë të vendosur, nëse duhet ta mbështesin apo ta kundërshtojnë të drejtën e personave LGBT të martohen është relativisht e lartë, rreth 37 për qind. Më këtë grup punonjësish duhet punuar për t'i informuar rreth të drejtës themeore të pasjes së një partneri në formë zyrtare.

Personat LGBT kanë të drejtë të krijojnë familje

Përgjigjet e të anketuarve ndaj së drejtës së personave LGBT për të krijuar një familje të tyre janë më refraktare edhe se sa ato për martesën. Vetëm 34 për qind e të anketuarve shprehen në favor të krijimit të familjes për personat LGBT, ndërsa 25 për qind shprehen kundër. Edhe për këtë të drejtë, ka një spektër të gjerë të anketuarish, rreth 41 për qind që nuk dinë si të përgjigjen: në favor apo në disfavor të së drejtës për të krijuar familje. Ky grup e shpreh qartë nevojën që ka për t'u trajnuar në fushën e të drejtave themelore të personave LGBT dhe sidomos për të çmitizuar frikën që shkakton martesa dhe familja homoseksuale që burojnë nga paniku moral.


LGBT kanë të drejtë të krijojnë familje



Personat LGBT janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje

Të anketuarit shprehen diçka më shumë se gjysma, rreth 56 për qind, se personat LGBT janë po aq korrektë sa edhe qytetarët e tjerë në sjellje dhe marrëdhënie me të tjerët.

LGBT janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje




Ajo që bie në sy tek të dhënat për këtë opinion është përqindja e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 38 për qind, që nuk janë të sigurtë për të përcaktuar se sa korrekte është sjellja e personave LGBT krahasuar me të qytetarëve të tjerë, gjë që vjen nga mosnjohja. Me këta punonjës duhet punuar për të marrë informacion dhe për t'iu mundësuar njohje dhe kontakte me organizatat e të drejtave të personave LGBT, për të thyer barrierat paragjyquese që vijnë nga mosinformimi.

LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë


Sikurse për opinionin e mësipërm, edhe për opinionin në lidhje me qëndrimet më pro sociale të personave LGBT krahasuar me të tjerët, ka një përqindje të lartë përgjigjedhënësish të pasigurtë, rreth 34 për qind, të cilët nevojitet të krijojnë njohje me personat LGBT.

LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë



Gjithesesi, të anketuarit që kanë një opinion pozitiv që varion, nga shumë deri në pak konfirmues, janë shumicë, rreth 51 për qind. Opinioni pozitiv mbështetet ose tek njohjet personale që ata kanë me personat LGBT ose tek perceptimi se duke përvetësuar karakteristika të sjelljes femërore, personat LGBT janë më pro socialë. Gjithashtu, të anketuarit që janë shprehur se personat LGBT janë më miqësorë mund ta mbështesin këtë opinion tek fakti se personat LGBT duke u vënë nën sulmin helmues të paragjykimeve dhe qëndrimeve mohuese, duhet të kenë zhvilluar një sjellje më miqësore për t'u pranuar si qytetarë me sjellje të mirë.

Personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta




Thua se 60 për qind e të anketuarve shprehen se qytetarët LGBT duhet të kenë të njëjtin akses tek gëzimi i të drejtave si gjithë të tjerët. Ndërsa ata që mendojnë se personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta se të tjerët janë vetëm 5 për qind. Mbase këta kanë pasur në mendje edhe të drejtën për t'u martuar dhe për të

krijuar familje. Ndërsa pjesa tjetër, rreth 31 për qind janë të pavendosur, duke u shprehur se nuk e dinë ose janë disi ose pak dakord që personat LGBT të kenë më pak të drejta. Si edhe në

përgjigjet e mësipërme, edhe këto të dhëna nxjerrin në pah nevojën që kanë punonjësit e administratës vendore për trajnime në fushën e të drejtave të personave LGBT.

Personat LGBT janë më inferiorë se të tjerët

Është pozitiv fakti që të anketuarit janë përgjigjur në një përqindje të konsiderueshme se personat LGBT nuk janë inferiorë ndaj të tjerëve, duke nënkuptuar me këtë se nuk kanë arsye përse të jenë. Vetëm 6 për qind e të anketuarve mendojnë se personat LGBT ndihen inferiorë për identitetin e tyre gjinor dhe orinetimin seksual.




Ata mund të ketë këtë opinion bazuar në mendësitë homofobe të shoqërisë shqiptare që nuk toleron devianca morale të sjelljes seksuale, si edhe në vështirësitë kryesisht psikologjike që duhet të ndeshin personat LGBT për të jetuar në një mjedis të mbushur me paragjykime kundër tyre. Gjithesësi rreth gjysma e të anketuarve, 50 për qind e tyre, ose një në dy punonjës është i pavendosur se si ndihen apo se si duhet të ndihen personat LGBT në Shqipëri. Ata nuk janë të informuar për përjetimet personale dhe jetët private të personave LGBT, prandaj hezitojnë të japin ndonjë mendim të përcaktuar për këtë çështje. Trajnimi, ndërgjegjësimi dhe informimi do t'i shërbente mjaft ekspozimit të tyre ndaj përjetimeve, nevojave, vështirësive dhe persekutimit që pësojnë personat LGBT për shkak të të qenit ndryshe.

5.6 Opinionet e punonjësve për personat LGBT sipas përkatësisë Gjinore

Krahasuar me meshkujt, punonjëset femra të bashkive ku u shtri studimi janë më tolerante ndaj personave LGBT. Kjo vihet re në opinionet e shprehura nga femrat përgjatë gjithë seksionit që ka të bëjë me të drejtat e personave LGBT për të marrë shërbime publike nga bashkia. Në lidhje me opinionin se si duhet t'i marrin shërbimet personat LGBT në bashki, me të tjerët apo veç të tjerëve, femrat shprehen më pozitivisht se meshkujt. Kështu shprehen se duhet të marrin shërbim njësoj si të tjerët 91.3 për qind e femrave, ndërsa shprehen kështu 79.1 për qind e meshkujve. Përsa i përket marrjes së shërbimeve veç të tjerëve, janë të këtij mendimi 8.7 për qind e femrave dhe 20.9 për qind e meshkujve ose rreth një e pesta e tyre.

Që femrat shfaqin një nivel më të ulët homofobie është gjerësisht e vërtetuar në literaturën për studimet gjinore. Meshkujt shfaqin një qëndrim më të theksuar homofob për shkak të edukimit strikt që nuk toleron shfaqjen e shenjave të dukjes ose të sjelljes homoseksuale, pasi homoseksualiteti mashkullor konsiderohet si deviancë dhe i identifikon ata me femrat dhe për pasojë është i ndëshkueshëm moralisht. Tek djemtë, përmes procesit të shoqërizimit, ushtrohet shumë trysni që ata t'i përmbahen kërkesave shoqërore të të qenit burrërorë dhe ta afirmojnë burrërinë ose mashkullaritetin duke refuzuar çdo gjë që vlerësohet si femërore. Meshkujt në përgjithësi, mundohen të censurojnë sjelljen dhe qëndrimet e veta për të qenë konform asaj çka shoqëria konsideron si të vlefshme moralisht për djemtë dhe burrat. Përmes aktivizimit të stereotipeve gjinore, që shkurajojnë çdo lloj shmangie nga norma shoqërore, meshkujt formojnë perceptime pak a shumë të ngurta mbi sjelljen shoqërisht të pranueshme për ta. Ata vetcensurohen dhe censurojnë edhe njëri-tjetrin si agjenci kontrolli shoqëror për të mos lejuar shkeljen e normave tradicionale kulturore që inkurajojnë patriarkinë dhe mashkullaritetin si trajtë pohuese të kulturës dominuese.

Shërbimet që duhet të marrin personat LGBT duhet të jenë




Gjithësesi, personeli i bashkive, sikurse administrata shtetërore në përgjithësi, ka një shumicë të dukshme punonjësesh vajza dhe gra, çka e bën mjedisin e administratës vendore më pak homofob. Me ndarjen e re administrative që shkurton rreth 80 për qind të fondeve të dedikuara për personel dhe rialokimin e tyre tek shërbimet publike pritet që të rritet edhe gama e shërbimeve publike në nivel vendor, prej të cilave do të përfitojnë më shumë qytetarë, përfshi edhe LGBT.

A janë personat LGBT si gjithë qytetarët e tjerë?

Edhe në lidhje me opinionin se a janë personat LGBT si të gjithë qytetarët e tjerë, femrat janë shprehur më pozitivisht se meshkujt. Rreth 70 për qind e femrave mendojnë se LGBT janë si gjithë të tjerët, ndërsa 62.5 për qind e meshkujve mendojnë kështu. Një pjesë e vogël e të anketuarve shprehen se janë “disi” dakord me këtë opinion, ata janë 14 për qind femra dhe 12.5 për qind meshkuj. Ndërsa punonjësit që mendojnë se LGBT nuk janë si të tjerët, pra kanë shmangie nga normaliteti janë 16.2 për qind femra dhe 25 për qind meshkuj. Pra siç duket edhe nga të dhënat e anketimit, meshkujt janë më refraktarë në opinionet e tyre rreth homoseksualitetit. Rreth një e katërta e punonjësve meshkuj të bashkive të përfshira

në studim janë homofobë të shfaqur, ata mendojnë se LGBT nuk janë normalë si gjithë të tjerët.


LGBT janë qytetarë si gjithë të tjerët



Personat LGBT kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët

Përsa i përket të drejtës për arsim, shumica e punonjësve bashkiakë mendojnë se personat LGBT duhet ta gëzojnë këtë të drejtë si të gjithë të tjerët dhe duhet të arsimohen në të njëjtat institucione arsimore me të tjerët. Edhe për të drejtën për arsim, shihet se femrat janë më pozitive se sa meshkujt, ato përbejnë 83.2 për qind të të anketuarave që janë shprehur pozitivisht për të drejtën për arsim në mjedise të përbashkëta, ndërsa meshkujt që janë përgjigjur pozitivisht për të drejtën për arsim përbejnë 77.1 për qind të të anketuarave. Vetëm një përqindje e vogël nga të dyja gjinitë janë disi, pak ose aspak dakord që personat LGBT të arsimohen në të njëjtat shkolla me të rinjtë e tjerë. Më të lëkundur rreth të drejtës se LGBT për t'u arsimuar janë meshkujt, të cilët përfaqësojnë rreth 23 për qind të të anketuarave meshkuj, ndërsa femrat 17 për qind të të anketuarave femra.

LGBT kanë të drejtë të arsimohen me të tjerët




Megjithatë, nga rezultatet e të dhënave del qartë se femrat janë më pak homofobe se sa meshkujt dhe shfaqin tolerancë më të madhe për të drejtat e LGBT.

Personat LGBT kanë të drejtë të punësohen në administratën publike

Opinionet në lidhje me të drejtën e LGBT për të punuar në administratën publike janë pak a shumë të njëjta me opinionet për të drejtën për t'u arsimuar dhe disi më pozitive se sa opinionet në lidhje me "normalitetin" e personave LGBT. Shumica e të anketuarve, si femra dhe meshkuj, janë shprehur poizitivisht për të drejtën e personave LGBT për të punuar në administratën publike. Ata vlerësojnë aftësitë profesionale të personit dhe jo orinetimin seksual si kriter për t'u punësuar në shërbimin civil. Mendojnë se personat LGBT mund të jenë punonjës të administratës publike rreth 73 për qind e femrave dhe 75 për qind e meshkujve të anketuar. Ka një diferencë gjinore tek punonjësit e lëkundur që janë shprehur disi (jo krejtësisht) dakord me punësimin e personave LGBT në administratën publike, janë 9.3 femrat që janë disi dakord dhe 4.2 meshkujt. Pra ka pak më shumë femra se sa meshkuj që miratojnë punësimin e LGBT në administratë dhe ka pak më shumë meshkuj që e kundërshtojnë këtë. Meshkujt që kundërshtojnë punësimin e LGBT në admistratë janë rreth një e pesta e meshkujve të anketuar, ndërsa femrat kundështuese përbëjnë rreth 18 për qind.

LGBTkanë të drejtë të punësohen në administratën publike




Në përqindje, si femrat dhe meshkujt kanë qëndrime të ngjashme ndaj punësimit të personave LGBT në administratën publike.

Personat LGBT kanë të drejtë të frekuentojnë të njëjtat mjedise shërbimi

Edhe në lidhje me frekuentimin e shërbimeve nga ana e LGBTnë të njëjtat mjedise me të tjerët, të anketuarit, pavarësisht gjinisë, ndajnë opinione të ngjashme. Janë shumë dakord që personat LGBT të marrin shërbime publike në të njëjtat mjedise me qytetarët e tjerë 78.6 për qind e femrave dhe 81.3 për qind e meshkujve të anketuar. Janë disi dakord 6.9 për qind e femrave dhe 4.1 për qind e meshkujve dhe janë pak ose aspak dakord rreth 14.5 për qind e femrave dhe 14.6 për qind e meshkujve të anketuar. Përgjithësisht, opinioni i të anketuarve, mbi 70 për qind është pozitiv, por gjithsesi është shqetësues fakti që rreth 14.5 për qind e të anketuarve nga të dyja gjinitë nuk e miratojnë marrjen e shërbimeve brenda të njëjtave mejdise.

LGBT kanë të drejtë të frekuentojnë të njehta mjedise shërbimi




Me të anketuarit e lëkundur në qëndrime dhe me të anketuarit kundërshtues nevojitet të kryehet më shumë punë informuese dhe edukative për të drejtat e personave LGBT si qytetarë m të drejta të barabarta, të cilëve u duhet shërbyer njësoj nga administrata vendore, pavarësisht dalimit seksual.

Personat LGBT kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat

Në përgjithësi, kur flitet për të drejtat e njeriut, punonjësit e administratës vendore shfaqin qëndrime politikisht korrekte, duke aprovuar në një mase të madhe ushtrimin e të drejtave nga ana e personave LGBT. Pozicioni i punës si shërbyes civilë ua kërkon që të shprehen korrektësisht, pavarësisht se sa të bindur mund të jenë me opinionin e shfaqur. Qëndrimi diplomatik u imponohet për shkak të detyrës më së shumti. Por është një fakt i ditur që qëndrimet nuk maten vetëm me anë të opinionëve, sidomos kur opinioni merret në rrethana të imponuara si pranë vendit të punës që nuk është një vend neutral për përgjigjdhënësin. Më së shumti qëndrimet maten nëpërmjet vrojtimit të sjelljes se sa përmes opinionëve, të cilat mund të jenë edhe false. Në pamundësi për të vëzhguar sjelljen e punonjësve të bashkive në ndërveprimin e përditshëm të tyre me personat LGBT, ky studim u kufizua vetëm tek opinionet e shprehura të punonjësve të anketuar, të cilat gjithësesi informojnë pjesërisht mbi të vërtetën e qëndrimeve të tyre ndaj personave LGBT.


LGBT kanë të drejtë të ankohen nëse ju shkelen të drejtat



Përgjithësisht, të anketuarit janë shprehur se personat LGBT kanë të drejtë të ankohen nëse u shkelen të drejta. Këtë pohim ata e bëjnë në kuadër të së drejtës qytetarë për ankim për këdo dhe jo për personat LGBT specifikisht. I njëjti shpjegim mund të jepet edhe në rastin e përgjigjeve të lëkundura, sipas të cilave personat LGBT edhe mund të ankohen për shërbimet, sikurse çdo qytetar i pakënaqur me shërbimin. Mendojnë se LGBT kanë pak ose aspak të drejtë të ankohen për shërbimet vendore 12.7 për qind e femrave dhe 18.8 për qind e meshkujve të anketuar. Siç edhe duket, mosaprovimi për ankimim është më i shprehur tek meshkujt se sa tek femrat e anketuara, me një diferencë prej 6 për qind. Nuk është e qartë nëse mosaprovimi i të drejtës për ankimim është vetëm për personat LGBT apo për të gjithë qytetarët. Për të sqaruar këtë dilemë duhet thelluar studimi në një stad të mëtejshëm.

Personat LGBT kanë të drejtë të martohen

Nëse për një mori të drejtash si: arsimimi në të njëjtat shkolla, marrja e shërbimit në të njëjtat mjedise dhe e drejta për t'u ankuar në rast pakënaqësie me shërbimin vendor miratohen prej shumicës së të anketuarve, me një diferencë të vogël mes gjinive, kur pyeten për të drejtën e personave LGBT për t'u martuar, të anketuarit nuk janë edhe aq aprovues. Përkundrazi, shkalla e disaprovimit për gëzimin e kësaj të drejte rritet.



Gjithësesi, femrat janë më aprovuese se sa meshkujt përsa i përket të drejtës së personave LGBT për t'u martuar. Ndër të anketuarit, ata që i miratojnë martesat mes homoseksualëve janë 45 për qind e femrave dhe 33.3 për qind e meshkujve. Femrat shfaqin edhe qëndrime te dyzuara rreth çështjes së martesës, me 11 për qind të tyre që shprehen se janë disi dakord që LGBT të martohen. Ndërsa meshkujt nuk kanë dyzime, ose janë pro ose janë kundër. Përqindja e meshkujve që kundërshtojnë martesat mes homoseksualëve është relativisht e lartë 66.7 për qind. Edhe pse përqindja e femrave kundërshtuese është më e ulët se e meshkujve, mbetet e lartë krahasuar me qëndrimet e femrave ndaj të drejtave të tjera të sipërpërmendura. Femrat janë të ndara gjithashtu në dy kategori, rreth 45 për qind e miratojnë martesën mes homoseksualëve dhe thuajse po aq, 44 për qind, e kundërshtojnë.

Në lidhje me të drejtën për martesë, të anketuarit kanë shfaqur një qëndrim më pak të trukuar se sa ai që kanë shfaqur për të drejta të tjera që lidhen me marrjen e shërbimeve

publike. Opinionet në lidhje me martesën, në përgjithësi, janë më kundërshtuese se sa pranuese, sepse institucioni i martesës është ngushtësisht i lidhur me familjen dhe rolet shoqërore të përcaktuara kulturalisht. Nëse marrja e një shërbimi nga ana e qytetarëve LGBT nuk trondit ndonjë korrnizë morale për të anketuarit, e drejta për t'u martuar është një kërcënim për normat kulturore që përcaktojnë martesën heteroseksuale monogame si të vetmen formë normale të martesës, ndërsa martesën homoseksuale, edhe pse monogame, e konsideron si deviancë. Të edukuar përmes normave shoqërore të kulturës shqiptare, dhe të ndikuar edhe prej kulturave të tjera që mbivlerësojnë martesën monogame mes një burri dhe një gruaje si të vetmen formë të vlefshme të martesës, të anketuarit që e kundërshtojnë martesën homoseksuale e konsiderojnë atë si një deviancë morale që duhet penguar të shfaqet. Prandaj numri i të anketuarve që kundërshtojnë të drejtën e martesës, ndërkohë që aprovojnë të drejtën për marrje shërbimesh, rritet.


Si marrës shërbimesh personat LGBT janë pasivë, në kuptimin që janë në pozita pritëse për të marrë diçka që u takon nga shoqëria, në formë shërbimi zyrtar. Ndërsa si ushtrues të së drejtës për t'u martuar, ata nuk janë më qytetarët pasivë, të cilët presin të shërbehen ose jo nga ana e punonjësve të administratës vendore, por janë subjekte aktive që marrin në dorë kontrollin e jetës së tyre duke iu imponuar shoqërisë. Në fushën e të drejtës së shërbimeve ata mund të jenë përfitues, ndërsa në fushën e të drejtës së martesës dhe familjes ata nuk mund të jenë, sepse janë të përjashtuar nga e drejta për t'u martuar në dy drejtime: moral (kulturor) dhe ligjor.

Kërcënimi i perceptuar prej të anketuarve se martesa homoseksuale zëvendëson martesën heteroseksuale dhe çon në krijimin e një forme të re familjeje që rrezikon egzistencën ekskluzive të familjes patriarkale shprehet edhe më shumë në pyetjen pasardhëse që ka të bëjë me opinionin e të anketuarve për të drejtën e personave LGBT të krijojnë familje. Ky shqetësim është i kotë, pasi forma ekskluzive e familjes patriarkale, si familje bërthame me patriarkun në krye dhe personat e tjerë nën varësinë ekonomike dhe pushtetin absolut të tij, ka kohë që ka filluar të zbehet që në fillimet e periudhës moderne të zhvillimit industrial, që shënoi edhe futjen e grave në tregun e punës me pagesë. Format e familjes aktualisht janë të shumta, ka familje me një prind, familje me një person, familje me fëmijë të sjellë nga martesat e mëparshme, familje me fëmijë të adoptuar, etj. Frika e të anketuarve dhe e shoqërisë në përgjithësi prej martesës së homoseksualëve është e pajustificuar.

Personat LGBT kanë të drejtë të krijojnë familje

Është edhe më i madh numri i të anketuarve që e kundërshtojnë të drejtën e personave LGBT për të krijuar familje, se sa i atyre që kundërshtojnë martesën. Qëndrimet ndaj pasjes së një familjeje të vetën janë edhe më intrasigjente. Veçanërisht, meshkujt janë shumë mosaprovues të së drejtës së homoseksualëve për të pasur familje. Rreth 75.0 për qind e të anketuarve meshkuj janë kundër të drejtës së personave LGBT për të pasur familje. Kjo përqindje është alarmuese, pasi mund të reflektojë opinionin e gjerë të popullatës më të arsimuar në vend. Punonjësit e bashkisë janë përgjithësisht me nivel të lartë arsimor dhe eventalisht përceptohen si njerëz me mendje të hapur për shkak të ekspozimit ndaj dijes, shkencës, informacionit dhe kulturës në përgjithësi. Nëse 75.0 për qind e punonjësve meshkuj të administratës vendore janë homofobë, treguesi i homofobisë tek meshkujt e tjerë, më pak të arsimuar, duhet të jetë edhe më e lartë.

Një përqindje të lartë të kundërshtimit të së drejtës për të pasur familje për personat LGBT zenë edhe femrat, rreth 48.5 për qind e tyre e kundërshtojnë këtë të drejtë. Pra, janë më të shumtë të anketuarit që e kundërshtojnë krijimin e familjes për personat LGBT se sa ata që e lejojnë.




Gjithësesi është shprehëdhënës numri i të anketuarve që e aprovojnë krijimin e familjes nga ana e personave LGBT. Janë 37.6 për qind e femrave dhe 20.8 për qind e meshkujve ata që mendojnë se personat LGBT nuk duhet të privohen nga e drejta themelore e pasjes së familjes së tyre. Femrat që mendojnë se familja është një e drejtë themelore për personat LGBT janë sa dyfishi i meshkujve që e mendojnë këtë. Femrat janë dukshëm më pranuese të të drejtave themelore për personat LGBT. Edhe tek të lëkundurit ka më shumë femra se sa meshkuj, rreth 14 për qind femra dhe 4.2 meshkuj, ose afërsisht 4 herë më shumë femra se sa meshkuj që mendojnë se kjo e drejtë edhe mund t'u takojë. Hezitimi për të pranuar me bindje martesën e personave LGBT vjen prej frikës së supozuar se ata nuk do të jenë në gjendje të prindërojnë sipas roleve sociale të përcaktuara shoqërisht për burrin e martuar dhe për gruan e martuar, për rolin tradicional të babait dhe të nënës, për modelet e gabuara që do t'u transmetojnë fëmijëve në lidhje me familjen patriarkale dhe raportet e pushtetit patriarkal të babait ndaj gruas dhe fëmijëve në familje, për mospërmblidhjen e roleve tradicionale të nënës dhe të babait, për romantizimin e marrëdhënies homoseksuale, për normalizimin e homoseksualitetit, për keqedukimin e fëmijëve dhe imponimin ndaj tyre për t'u bërë homoseksualë, etj.

Opinionet e të anketuarve tregojnë për nevojën e madhe që ata kanë për t'u sensibilizuar për të drejtat e njeriut dhe sidomos për të drejtat themelore të personave LGBT për t'u martuar dhe për të krijuar familje. Në funksion të ndryshimit të qëndrimeve mohuese për të drejtat themelore të martesës dhe familjes ndaj personave LGBT, lipset të sillen shembuj të praktikave pozitive të martesave mes personave LGBT dhe të familjeve të krijuara prej tyre. Largimi nga normat patriarkale të dominimit dhe pushtetit mashkullor mbi pjesëtarët e tjerë të familjes, barazia që tregojnë bashkëshortët homoseksualë në ndarjen e detyrave dhe punëve brenda familjes si dhe në ndarja në mënyrë egalitare e përgjegjësiwe përkujdesëse ndaj fëmijëve mund të sillen si faktorë pozitivë për ndërtimin e një familjeje funksionale, me gjasa të reduktuara të konflikteve martesore dhe prindërore.

Personat LGBT janë po aq korrektë sa qytetarët e tjerë në sjellje

Përgjithësisht opinionet për sjelljen e personave LGBT janë pozitive. Femrat më shumë se meshkujt e ndajnë këtë opinion, përkatësisht me 57.8 për qind (femra) dhe 50.0 për qind (meshkuj). Sic shihet nga të dhënat, gjysma e meshkujve të anketuar mendojnë se personat LGBT sillen në mënyrë korrekte. Pjesa tjetër e tyre ose mendojnë të kundërtën (37.5 për qind), që personat LGBT nuk janë po aq korrektë sa edhe qytetarët e tjerë, ose janë të pavendosur (12.5 për qind).




Gjysma e të anketuarve meshkuj mendojnë se personat LGBT nuk sillen në mënyrë korrekte si qytetarët e tjerë. Ata e bazojnë këtë opinion tek fakti se personat LGBT nuk janë si gjithë të tjerët, sepse shkojnë kundër skripteve morale të heteronormativitetit, e për pasojë ata janë deviantë, me moral të korruptuar dhe me sjellje të papëlqyeshme. Niveli i lartë i meshkujve të anketuar që mendojnë se personat LGBT nuk sillen “mirë” si qytetarët e tjerë është një tregues shqetësues për nivelin e homofobisë tek punonjësit meshkuj të administratës vendore që kërkon një ndërhyrje të shpejtë. Nëse personat LGBT do të kërkonin shërbime prej këtyre punonjësve ata do refuzoheshin me pretekstin meqë ata nuk janë si qytetarët e tjerë ata janë anormalë, deviantë dhe nuk e meritojnë të shërbejnë si gjithë qytetarët e tjerë. Personat LGBT kanë më shumë mundësi të marrin shërbim nga punonjësit femra të administratës vendore, ndër të cilat 75.7 mendojnë se janë ose mund të jenë korrektë në sjellje po aq sa qytetarët e tjerë.

Personat LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë

Në lidhje me opinionin se personat LGBT janë më miqësorë se sa njerëzit e tjerë, përgjithësisht të anketuarit janë shprehur me rezerva. Rreth 70 për qind e meshkujve dhe rreth 50 për qind e femrave të anketuara mendojnë se personat LGBT nuk janë më miqësorë se të tjerët. Ata mendojnë se nuk ka ndonjë arsye që personat LGBT të jenë më miqësorë. Këtë opinion ata e mbështesin në krahasimin që i bëjnë personave LGBT me veten dhe me njerëzit e tjerë.

LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë




Gjysma e femrave të anketuara mendojnë se personat LGBT janë më miqësorë se njerëzit e tjerë. Ky opinion mbështetet në njohjet që ato kanë pasur me personat LGBT ose në opinionet e të tjerëve që kanë njohje personale me ta. Në fakt egziston një mit rreth sjelljes miqësore të personave LGBT, sidomos të homoseksualëve (gay), sikur janë shumë më miqësorë se sa meshkujt e tjerë për shkak të përvetësimit prej tyre të karakteristikave të sjelljes pro sociale që konsiderohet si atribut femëror. Pra meqë femrat janë më empatike se sa meshkujt dhe meshkujt gay kanë një identitet gjinor që përngjason me femrat edhe sjellja e tyre është më feminine pra më empatike se sa e meshkujve të tjerë. Meshkujt gay konsiderohen si më pak agresivë dhe dominues se sa meshkujt heteroseksualë.

Femrat pohojnë se ndihen më të sigurta, të pamolestuara seksualisht dhe më rehat në prani të një mashkulli homoseksual se sa një mashkulli heteroseksual. Për femrat homoseksuale, duke qenë se ato janë femra dhe si të tilla i janë nënshtruar procesit të formimit kulturor dhe identitar – sipas të cilit femrat janë empatike, pro sociale dhe të orientuara ndaj plotësimit të nevojave të të tjerëve - si gjithë femrat e tjera në shoqërinë tonë, nuk vihet në diskutim që janë më empatike se meshkujt. Prandaj ndër të anketuarit, fëmrat zenë përqindjen më të lartë të atyre që mendojnë se personat LGBT janë më miqësorë se të tjerët.

Personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta

Të anketuarit shprehen në shumicë se personat LGBT duhet të gëzojnë të drejta të njejta me të tjerët. Janë të këtij mendimi 86.7 për qind e femrave dhe 81.5 për qind e meshkujve të anketuar. Ky opinion është paksa kontradiktor me opinionet në lidhje me martesën dhe familjen, të drejta që konsideroheshin përgjithësisht të palejueshme prej punonjësve të administratës vendore, sidomos prej meshkujve. Me të drejta, të anketuarit do të kenë nëkuptuar të drejta të lidhur me jetën dhe me shërbimet bazë si shërbimi arsimor, shëndetsor, punësimi, etj, përvec martesës dhe familjes.

LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta




Të anketuarit që mendojnë se personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta se të tjerët janë 8.1 për qind femra dhe 18.8 për qind meshkuj. Siç duket nga të dhënat, meshkut janë më homodobë se femrat, pasi zenë një përqindje më të lartë se sa femrat si kundërshtues të të drejtave të personave LGBT. Pothuajse një në dhjetë femra mendon se personat LGBT duhet të gëzojnë më pak të drejta, ndërsa numri i meshkujve që kundërshton të drejtat e personave LGBT është sa dyfishi i femrave, domethënë afërsisht një në pesë meshkuj mendon negativisht.

Personat LGBT janë më inferiorë se të tjerët

Shumica e të anketuarve shprehen se personat LGBT nuk kanë arsye përse të ndihen më inferiorë se të tjerët. Të këtij mendimi janë 81.25 për qind e meshkujve dhe 76.3 për qind e femrave të anketuara. Ndër të anketuarit e lëkundur shumicën e përbëjnë femrat, 18.5 për qind, të cilat mendojnë se ka mundësi që personat LGBT të ndihen inferiorë për shkak të diskriminimit që mund të ndiejnë si pasojë e pasjes së një identiteti gjinor dhe orientimi seksual jashtë kornizës heteronormative. Afërsisht, një në pesë femra mendon se ka shumë mundësi që personat LGBT të ndihen inferiorë ndaj të tjerëve për atë që janë, pasi identiteti dhe sjellja e tyre janë kundërthënëse me normat e moralit heteroseksist që devalorizon çdo lloj forme të identitetit gjinor që nuk përputhet me karakteristikat e përcaktuara shoqërisht për gjinitë.

LGBT janë më inferiorë se të tjerët



Pothuajse një në dhjetë meshkuj, 8.33 për qind, mendon se personat LGBT janë më inferiorë se të tjerët. Si arsye mund të jetë fakti që LGBT perceptohen si deviantë dhe si të tillë etiketohen si anormalë, gjë që i ekspozon ndaj kompleksit të inferioritetit dhe vetfajsimit. Mospërputhja me kërkesat shoqërore për gjininë shkakton tek personat LGBT ndjesinë e turpërimit, të vetvlerësimit të ulët, të vetgjyqimit dhe vetnëshkimit, të gjitha këto karakteristika të inferioritetit.

5.7 Trajnimet e punonjësve për të drejtat dhe konceptet LGBT

Trajnimet për të drejtat e LGBT

Është shumë e lartë përqindja e të anketuarve që shprehen se nuk kanë përfituar asnjë lloj trajnimi për të drejtat e personave LGBT, 75.1 për qind. Kjo përqindje justifikon jo vetëm nivelin e homofobisë në rradhët e punonjësve bashkiakë, por edhe nevojën e madhe për trajnim në fushën e të drejtave të njeriut dhe të shërbimeve humane.




Pjesa tjetër, rreth 30 për qind e të anketuarve, deklaroi se ka marrë trajnime për shkak se e ka kërkuar vendi i punës dhe kur u është ofruar në kuadër të marrëdhënieve të punës nga OJF-të.

Trajnimet: shpeshtësia e tyre

Sikurse për trajnimet, edhe për shpeshtësinë e trajnimeve të marra mbi 70 për qind e punonjësve shprehen se nuk janë trajnuar asnjëherë, ndërsa ata që janë trajnuar kanë marrë 1 deri në 2 seanca trajnim. Edhe këto mund të jenë të pamjafrueshme për t'i pajisur punonjësit bashkiakë me shprehje pune që kanë brenda dimension emocional dhe përkujdesës ndaj personave LGBT dhe gjithë grupeve të tjera të diskriminuara.

Denduria e trajnimeve




Mbase do të ishin shumë të nevojshme trajnimet përgjatë punës, në mënyrë që punonjësit të shmangin qëndrimet homofobe dhe të përshtasin sjelljen e tyre ndaj personave LGBT me standartet humane të profesionit.

Trajnimet: temat me interes

Rreth 30 për qind e të anketuarve shprehen se nuk kanë interes për trajnime, ndërsa 70 për qind pohojnë se kanë nevojë të trajnohen. Kërkesa e thuar dy të tretave të punonjësve për trajnim është një ftesë e hapur për organizatat e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut për të ofruar shërbime për punonjësit bashkiakë.


Interes për trajnime



Rreth një e treta që nuk shpreh interes për trajnime korrespondon me përqindjen që kanë marrë trajnim në kuadër të punës, nga OJF të ndryshme.

Trajnimet sipas fushës

Të anketuarit shprehen se kanë interes të trajnohen në shumë drejtime, duke filluar që nga konceptet bazë për homoseksualitetin dhe të drejtat e personave LGBT, për të cilat janë të interesuar rreth 19.2 për qind. Një pjesë e punonjësve, 18.3 për qind, kërkojnë trajnim në fushën e shërbimeve me fokus personat LGBT. Të tjerë, rreth 15.6 për qind shprehen se u duhet trajnim për sistemin e referimit dhe shërbimet me bazë komunitare për personat LGBT.




Me interes është përqindja e punonjësve, 27.7 për qind, që interesohen të mësojnë rreth përvojave ekzistuese të punës me personat LGBT, prej të cilave mund të mësojnë edhe vetë se si të punojnë me këtë grup qytetarësh. Por, rreth 40 për qind e të anketuarve që kanë kërkuar të trajnohen nuk e kanë specifikuar se në cilën fushë do t'u nevojitej trajnim, duke nënkuptuar se të gjitha fushat mund të jenë me interes për ta.

Praktikë pune pozitive me LGBT

Rreth 71 për qind e të anketuarve nuk kanë dijeni për praktikën e mira të punës me personat LGBT. Ata janë krejtësisht të painformuar se si punohet me personat LGBT dhe janë në nevojë për informim. Të vetmit që janë njohur me praktika të mira janë ata që janë trajnuar, rreth 29 për qind. Pra shumica e të anketuarve janë në nevojë urgjente për trajnim për praktikën e mira të punës me personat LGBT.


Praktika të mira pune



Sektor pune të veçantë për LGBT

Punonjësit u pyetën edhe për nevojën e krijimit të një sektori për të drejtat e personave LGBT. Rreth 46 për qind shprehen se nuk është e nevojshme të ngrihet një sektor pune për personat LGBT, ndërsa 35 për qind pohojnë se duhet ngritur dhe 19 për qind nuk dinë nëse duhet apo jo një sektor pune i posaçëm për ta. Ata që shprehen se nuk duhet ngritur sektor i veçantë pune mendojnë se personat LGBT duhet të gjejnë zgjidhje për problemet e tyre tek të njëjtët sektorë pune në bashki si gjithë të tjerët.


Sektor për LGBT



Studime sociale ku përfshihet orientimi seksual

Punonjësit janë pyetur edhe nëse kanë dijeni për studimet që janë ndërmarrë për orinetimin seksual si një e drejtë njerëzore. Rreth 60 për qind shprehen se nuk ka studime të tilla, ndërsa 20 për qind shprehen se nuk janë në dijeni. Vetëm 20 për qind e punonjësve të anketuar, të cilët kanë marrë informacion përmes trajnimeve janë shprehur se ka studime për orientimin seksual.


Studime ku përfshihet orientimi seksual




Arritjet në zbatimin e ligjit për mosdiskriminim

Të anketuarit u pyetën edhe për ligjin për mosdiskriminim, se sa dijeni kanë për të dhe sa zbatohet ai prej tyre. Rreth 36.6 për qind e punonjësve të anketuar janë shprehur se e njohin ligjin për mosdiskriminim. Por vetëm 9.8 për qind shprehen se janë marrë masa për zbatimin e ligjit në nivel vendor. Një pjesë e konsiderueshme nuk kanë dijeni nëse ligji antidiskriminim zbatohet apo jo, dhe 9.8 për qind shprehen se ligji nuk zbatohet. Rreth 41.8 për qind mendojnë se nevojiten veprimtari ndërgjegjëse për ligjin dhe mbështetje institucionale për zbatimin e tij.

Arritjet për ligjin mosdiskriminim për LGBT




Sektorët ku duhet përfshirë mbrojtja e LGBT



Punonjësit u pyetën se në cilët sektorë duhet përfshirë çështja e personave LGBT. Gati gjysma e të anketuarve mendojnë se çështjet që u përkasin personave LGBT duhen përfshirë në sektorin e çështjeve sociale, aty edhe ku ofrohet mbrojtje sociale. Vetëm 8 për qind mendojnë se çështjet për personat LGBT duhen përfshirë në mënyrë transversale në të

gjithë sektorët e shërbimit vendor.

Veprimtaritë që nevojiten aktualisht



Të pyetur se çfarë veprimtarish duhen ndërmarrë për të rritur mundësitë që personat LGBT të marrin shërbime cilësore në bashki, gjysma e të anketuarve mendojnë se duhen ndërmarrë më shumë veprimtari ndërgjegjësuere (34 për qind) për të drejtat e personave LGBT, trajnime dhe informim stafi rreth të drejtave themelore dhe të drejtës për shërbime (14 për qind) dhe nuk e dinë se çfarë duhet më

shumë rreth gjysma e të anketuarve.

6. Gjetjet kryesore te studimit

Në përfundim të këtij procesi, studimi identifikoi një serë gjetjesh të cilat po i grupojmë në katër fusha kryesore, si më poshtë:

Zyrtarët vendorë dhe njohja me komunitetin LGBT

- Zyrtarët vendor në gjashtë bashkitë që u bënë pjesë e studimit ishin të hapur për t'u bërë pjesë e studimit për një çështje që në të vërtetë është sensitive për shumë persona. Ky është një tregues i rritjes së maturisë së institucioneve publike vendore, të cilat përtej detyrimit ligjor për të mbështetur çdo qytetar që jeton në territorin e tyre, ishin të hapur për të biseduar dhe për t'u intervistuar në kuadër të këtij studimi. Niveli i lartë i përgjigjeve (64%) është një tregues se një pjesë e mirë e bashkive të mëdha në vend janë të gatshme të ndërmarrin nisma në mbështetje të komunitetit LGBT, përtej detyrave institucionale ligjore apo thjesht e vetëm për shkak të respektimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.
- Nga analiza e të dhënave demografike, Gjimore dhe në bazë të bashkive, vihet re se zyrtarët që kanë studiuar për profesione më bazë të fortë sociale janë edhe më të hapur për të mbështetur dhe punuar për avancimin e të drejtave të personave LGBT. Në këtë aspekt përbën një gjetje të pritshme që sektorët dhe profesionistët me më pak trainime dhe më pak në kontakt me komunitetin janë edhe ata që janë më rezistent për të pranuar dhe punuar për komunitetin LGBT.

Qendrimet e zyrtarëve vendorë përkundrejt personave LGBT

- **Qendrimet negative** përkundrejt personave LGBT ndikojnë drejtëpërsëdrejt në cilësinë e ofrimit të shërbimeve në nivel vendor. Rreth 9% e zyrtarëve publikë vendorë deklarojnë se kanë qendime negative (pra nuk duan) që t'i ofrojnë shërbime personave LGBT ndërsa 15% të tjerë janë të pasigurtë në këtë drejtim. Ky nivel i lartë qendrimi negativ është i lidhur si me mungesën e kontakteve direkte me komunitetin LGBT, mungesën e informacionit si dhe të trainimeve në fushë. Mungesa e politikave, kodeve të sjelljes apo standarteve bazë të punës me minoritetet në çdo bashki rrit mundësinë e përforsimit të qendrimeve negative, në vend që ato me kalimin e kohës të eliminohen tërësisht;

- **Refuzimi i shërbimit (5%), dhuna verbale (7% në total) dhe fizike (3%) apo ngritja e shërbimeve të veçanta për personat LGBT (2.2 % dhe 6.3%)** janë tregues se mungesa e standarteve të komunikimit dhe supërvizimit të ofrimit të shërbimeve i detyron një pjesë të vogël të zyrtarëve publikë të jenë përjashtues, ndëshkues dhe diskriminues ndaj personave LGBT. Ky qëndrim mund të jetë i njëjtë edhe për personat jo LGBT, por për shkak të mungesës së studimeve është e vështirë që të analizohet ky aspekt. Çdo formë dhunë e zyrtarëve publikë dhe institucioneve është e para e ndaluar me ligj dhe së dyti, e papranueshme, pasi dhunon të drejtat bazë të njeriut të çdo individi. Pavarësisht se nuk janë studiuar pasojat që ka patur refuzimi i shërbimeve apo dhuna ndaj personave LGBT, ajo çka mund të thuhet është se qëndrime të tilla vetëm përforcojnë sjelljet negative ndaj personave LGBT dhe rrjedhimisht edhe përjashtimin e tyre të mëtejshëm social, gjë që është në kundërshtim me të gjithë politikën shtetërore dhe legjislacionin vendas. Në një gjykim më personal, ky lloj përjashtimi dhe diskriminimi nuk iu jep mundësi personave LGBT që të arrijnë të zhvillojnë potencialin e tyre njerëzor dhe si pasojë edhe kontributi i tyre në shoqëri nuk do të jetë i konsiderueshëm. Shoqëria ka tendencën që vetëm të humbasë zhvillimin që vjen kur të gjithë individët kanë mundësinë që të japin maksimumin e tyre në terma të zhvillimit human, kulturor, ekonomik etj;
- **Mosha, aspektet kulturore dhe traditat** mund të bëhen ndonjëherë pengesë për ofrimin e shërbimeve të barabarta për qytetarët, përfshi edhe personat LGBT. Nga krahasimi i bërë ndërmjet gjashtë bashkive rezulton se disa bashki kanë nivel më të lartë të ofrimit të shërbimeve miqësore për personat LGBT (Korça psh) sesa disa të tjera (Durrës dhe Vlorë). Nga ana tjetër mosha është një kontribues i rëndësishëm në pranimin dhe respektin e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Sa më i ri më moshë të ishte personi aq më pozitive ishte tendenca e zyrtarëve publikë vendorë për të punuar dhe pranuar personat LGBT. Në vetëvete kjo do të thotë që në trainimet dhe informacionin që ofrohet për zyrtarët nga vetë bashkia, mosha duhet të jetë një faktor që duhet marrë në konsideratë për të përforcuar qëndrime të reja dhe pozitive, që ndihmojnë ofrimin e shërbimeve.
- **Gratë dhe vajzat zyrtare publike** janë më të hapura dhe mbajnë qëndrime më pozitive përkundrejt personave LGBT, krahasuar me djemtë dhe burrat. Ka një serë studimesh që shpjegojnë shkaqet dhe faktorët që shpen në diferenca të tilla midis gjinive. Ajo cka paraqet rëndësi për politikanët vendorë dhe për të gjithë ata që punojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve është fakti se gjinia dhe seksi janë një faktor që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët;
- **Feja dhe besimi fetar** nuk janë një faktor vendimtar që ndikon në mos-ofrimin e shërbimeve përkundrejt komunitetit LGBT, por as një faktor që duhet neglizhuar. Të dhënat e mbledhura dhe të analizuara në studim tregojnë se një pjesë e zyrtarëve vendorë, pavarësisht se e ushtrojnë fenë vetëm në ditët e festave fetare etj, përsëri kanë tendencën që të ofrojnë më pak shërbime (myslymanët dhe ortodoksët) sesa

disa besime të tjera fetare (protestantët psh). Ndonëse diferencat midis feve nuk janë të konsiderueshme, përsëri ato mund të ndikojnë në nivelin e shërbimeve apo refuzimin e ofrimit të shërbimit përkundrejt personave LGBT. Në këtë aspekt më shumë punë duhet bërë për forcimin profesional të shërbimeve vendore dhe informimin e çdo zyrtari publik se besimi fetar dhe e drejta për të përfituar shërbime, janë dy të drejta që as konkurojnë dhe as kundërshtojnë njëra-tjetrën. Përtej kësaj, përforcimi i karakterit laik të shtetit dhe institucionit duhet të garantojë respekt për çdo të drejtë njerëzore dhe jo vetëm për disa;

Opinionet dhe perceptimet e zyrtarëve për personat LGBT

- Një ndër gjetjet kryesore të studimit ishte **niveli i lartë i mbështetjes së të drejtës për martesë dhe për të krijuar familje për personat LGBT**. Në kundërshtim me pritshmëritë dhe diskursin publik kunder martesës në gjini të njejtë, studimi gjeti se rreth 42% e zyrtarëve publikë vendore ishin dakord me martesën në gjini të njejtë dhe 34% për krijimin e familjeve LGBT. Ky qëndrim ishte më i lartë ndërmjet zyrtarëve në moshë më të re dhe grave, krahasuar me burrat. Kjo gjetje në vetëvete hedh poshtë edhe shumë perceptime negative ndërmjet politikanëve, zyrtarëve apo edhe vetën komunitetit, që martesa dhe familja LGBT nuk gëzon mbështetje në Shqipëri. Pavarësisht se kampinoni nuk është përfaqësues, fakti që të dhënat konfirmohen në të gjitha Bashkitë, pa ndonjë diferencë të madhe, ai është tregues i një qëndrimi pozitiv të përgjithshëm përkundrejt barazisë në familje dhe martesë midis personave LGBT dhe atyre në gjini të kundërt.
- Pavarësisht se në tërësi studimi ka gjetje pozitive në drejtim të qëndrimeve përkundrejt komunitetit LGBT, përsëri **ka një nivel të lartë paragjykimesh, mospranimit apo refuzimi për barazinë midis personave LGBT dhe atyre heteroseksualë**. Kështu studimi arriti të identifikonte se 32% e të intervistuarve mendonin se personat LGBT janë më inferiorë se pjesa tjetër e qytetarëve; 24% e tyre mendojnë se personat LGBT nuk duhet të punësohen në administratën publike; 26% e të pyeturve thonë se personat LGBT nuk janë qytetarë si gjithë të tjerët dhe së fundmi 10% e zyrtarëve mendojnë se personat LGBT duhet të kenë më pak të drejta se të tjerët. Të gjitha këto mendime dhe perceptime sigurisht që e japin impaktin e tyre negativ në drejtim ose të refuzimit të shërbimeve ose mos-dhënies së shërbimeve të duhura përkundrejt çdo personi LGBT, që rrjedhimisht shkakton si pasojë diskriminim dhe përjashtim social të mëtejshëm të tyre;
- Zyrtarët publikë u pyetën edhe nëse do të mbështesnin manifestimet publike të tipit Pride apo festivale për të drejtat dhe kulturën LGBT. Rreth 50% e zyrtarëve u deklaruan se nuk kishin interes për të marrë pjesë në manifestime. Kjo në vetëvete është një tregues i neglizhencës dhe dëshirës për të mos u përfshirë në ngjarje apo aktivitete që forcojnë pranueshmërinë e grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Nga ana tjetër mos-interesi për të marrë pjesë, që në vetëvete nuk është refuzim,

është tregues edhe i mungesës së kulturës së mbështetjes publike të kauzave sociale të vështira, mungesës së informacionit dhe frikës së paragjytimeve apo qendrimeve negative që shoqëria mund të ketë për pjesmarrje të tilla. Ky tregues është i vlefshëm sidomos për komunitetin LGBT në drejtim të ndërtimit të aleancave me institucionet dhe zyrtarët publikë.

- Zyrtarët publikë kanë një nivel të lartë paragjyimesh dhe mos-pranimi përkundrejt transgjinjorëve. Nisur edhe nga fakti që një pjesë e komunitetit transgjjinor jeton në kushte ekstreme të varfërisë, në rrugë apo duke ushtruar prostitucion, përjetimet që zyrtarët publikë kanë ndaj tyre ndryshojnë nga ato përkundrejt personave LGB. Ky ndryshim është edhe tregues i mungesës së përgatitjes së zyrtarëve publikë për t'u përballur me identitetin gjinor, si një çështje komplekse që kërkon vemendje të posaçme institucionale.

Niveli i trainimeve dhe nevoja për trainime të vazhdueshme për zyrtarët publikë vendorë

- Zyrtarët publikë kanë një nivel tepër të lartë të njohjes së koncepteve për të drejtat LGBT dhe si rrjedhojë edhe një mungesë në drejtim të marrjes së trainimeve përkatëse. Rreth 75% e të gjithë zyrtarëve vendorë të intervistuar deklaruan se nuk ishin trainuar asnjëherë në këtë fushë specifike të të drejtave të njeriut dhe as për konceptet bazë LGBT. Nga ana tjetër duhet vlerësuar fakti që 43% e zyrtarëve shprehin interes për t'u trainuar, ndërkohë që thuhet se 30% e tyre nuk kanë interes për këto trainime.
- Një tjetër gjetje interesante e studimit ishte fakti se pavarësisht se Shqipëria ka një legjislacion të përparuar në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale, rreth 81% e zyrtarëve vendorë të intervistuar nuk ishin të informuar nëse të dhënat personale të personave LGBT ishin trajtuar në një mënyrë të tillë që të garantonin privatësinë e tyre dhe mbrojtjen e identitetit të tyre në lidhje me orientimin seksual apo identitetin gjinor. Kjo është jo vetëm tregues i mos-njohjes së normave dhe kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, por edhe i mungesës së protokolleve për mbrojtjen e grupeve specifike, gjë që mund të shkaktojë pasoja negative apo edhe ekstreme në jetën e personave LGBT;

7. Rekomandimet e studimit

Në përfundim të të gjithë analizës së kryer në kuadër të këtij studimi, studiuesit rekomandojnë sa më poshtë:

1. Rekomandime për Kuvendin e Shqipërisë

Kuvendi luan një rol të pazëvendësueshëm për njohjen dhe përmirësimin e situatës të të drejtave të njeriut të personave LGBT. Ky rol nuk mund të kufizohet vetëm në dhënien e rekomandimeve për institucionet publike në të gjitha nivelet, por përkundrazi ai duhet shtrirë edhe në rritjen e kërkesës së llogarisë përkundrejt të gjitha institucioneve dhe zyrtarëve publikë. Në këtë drejtim ne i rekomandojmë Kuvendit të Shqipërisë sa më poshtë:

- Thirrja e seancave të vazhdueshme degjimore me përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe nga komuniteti LGBT në vend, për të evidentuar fushat prioritare ku Qeveria dhe Bashkitë duhet të kushtojnë më shumë vemendje apo fonde për përmirësimin e situatës ku jetojnë personat LGBT;
- Nxitja e vazhdueshme e institucioneve të të drejtave të njeriut, që raportojnë në Kuvend mbi baza vjetore, për të përgatitur dhe dorëzuar Raporte të Posaçme mbi çështje specifike të të drejtave të njeriut të personave LGBT si: punësimi, aksesimi në shëndetësi, strehimi, mbrojtja sociale, e drejta për arsim, mbrojtja nga dhuna etj;
- Përgatitja dhe miratimi i ligjeve të reja në fushën e të drejtave të njeriut, në bashkëpunim me institucionet publike dhe përfaqësuesit e komunitetit LGBT, në fusha si e drejta për bashkëjetesë, kujdes shoqëror, e drejta e strehimit etj;

2. Rekomandime për Qeverinë Shqiptare

Pavarësisht se pushteti vendor gëzon një gradë të lartë autonomie nga Qeveria qendrore, përsëri marrëdhënia e tyre dhe përgjegjësitë e përbashkëta që ato ndajnë, e bëjnë rolin e Qeverisë të pazëvendësueshëm. Në këtë aspekt, nisur edhe nga gjetjet e studimit, ne rekomandojmë sa më poshtë:

- Krijimi i një sektori për të drejtat e personave LGBT pranë Ministrisë së Mirëqenies, me qëllim të zbatimit të planit kombëtar të veprimit 2016-2020, dhe së dyti, për të nxitur Zhvillimin e politikave dhe standarteve të reja për përfshirjen dhe respektin e personave LGBT në të gjitha nivelet e qeverisë dhe organeve të saj. Do të ishte

pozitive edhe krijimi i nismave apo praktikave të diskriminimit pozitiv, ku Qeveria punëson persona LGBT në institucione publike;

- Mbështetja publike e lëvizjes dhe komunitetit LGBT është tepër e rëndësishme për rritjen e vizibilitetit të kësaj kauze të rëndësishme për të drejtat e njeriut. Studimet kanë provuar se përfshirja e politikanëve dhe zyrtarëve publikë në promovimin dhe mbështetjen e kauzës LGBT nuk ka pasoja negative në karrierën e tyre politike, gjë që hedh poshtë shumë mite që egzistojnë edhe në Shqipëri në lidhje me këtë çështje. Pranimi i hapur dhe mbështetja e personave LGBT rrit masën e respektit të të drejtave të njeriut, tolerancën në komunitetet qytetare, si dhe ndikon në uljen e dhunës në familje, komunitet dhe publik përkundrejt tyre.
- Qeveria duhet të përfshijë komunitetin LGBT në çdo politikë të saj zhvillimore e çdo ligj në këtë fushë, si një ndër grupet shoqërore më të përndjekura, diskriminuara dhe me të përjashtuara sociale. Pavarësisht se një pjesë e mire e personave LGBT nuk jetojnë në kushte ekstreme, diskriminimi, dhuna dhe përjashtimi janë prezente vazhdimisht në jetën e tyre. Këtë e tregojnë si studimet në nivel European ashtu edhe ato në Shqipëri. Në këtë kuadër një mbrojtje më e mirë e bazuar në politika dhe ligje më të mira është një para-kusht për të përmirësuar situatën dhe jetesën e personave LGBT;

3. Rekomandime për pushtetin vendor (Bashkitë)

Pushteti vendor ka jo vetëm detyrë institucionale dhe Ligjore, por edhe morale respektimin e të drejtave të njeriut pa diskriminim për çdo qytetare. Në këtë drejtim, pas riorganizimit të pushtetit vendor, është bërë gjithnjë e më e rëndësishme dhe parësore roli që luajnë zyrtarët publikë vendorë në ofrimin e shërbimeve dhe mundësive për të gjithë grupet në nevojë apo të risk, përfshi edhe personat LGBT. Për të forcuar punën e pushtetit vendor (61 Bashkive), studimi rekomandojnë sa më poshtë:

- Forcimi i kontakteve dhe bashkepunimit midis zyrtarëve publikë vendore dhe organizatave dhe përfaqësuesve të komunitetit LGBT. Bashkitë dhe OJF-të LGBT mund të ndërtojnë programe të përbashkëta ndërhyrjeje që përmirësojnë cilësinë dhe nivelin e shërbimeve vendore, futjen e praktikave të reja pozitive dhe rritjen e pranimi dhe respektimit të vetë personave LGBT. Kësaj mund t'i shërbejë edhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësores apo kulturore në datën 17 Maj, që njihet edhe si dita ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë;
- Zyrtarët publikë vendor kanë nevojë urgjente për trainime për të drejtat e njeriut dhe sidomos për konceptet LGBT. Ka ende zyrtarë publikë që mendojnë apo shprehen se të qenit LGBT është sëmundje apo behët për snobizëm. Mungesa e

dijeve, informacionit dhe qendrimeve zyrtare në këtë drejtim vetëm e shtojnë masën e mos-pranimit dhe mos-respektit të të drejtave të njeriut. Studimi rekomandon krijimin e një programi kombëtar trainimi për të gjithë zyrtarët publikë dhe ndarjen e informacionit zyrtar, në mënyrë që të eliminohen të gjitha paragjykimet që ndikojnë në cilësinë apo dhënien e shërbimeve për personat LGBT;

- Po në vijim të këtij argumenti, është mëse e nevojshme që çdo Bashki të zhvillojë një politikë të mos-diskriminimit, ku përfshihet edhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor, e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë zyrtarët apo të kontraktuarit e Bashkisë (njesisë vendore). Kjo mund të realizohet edhe përmjet përgatitjes dhe nënshkrimit të një Kodi Sjellje për Eliminimin dhe Denoncimin e Diskriminimit apo edhe krijimit të praktikave të vlerësimit të zyrtarëve që ofrojnë shërbime miqësore për personat LGBT (dhe jo vetëm);
- Shumë njesi vendore nuk kanë të vendosur apo të instaluar në Bashki një zyrë Ankesash, e cila në mënyrë të Pavarur do të verifikonte dhe trajtonte çdo ankesë për mos-dhënie apo refuzim shërbimi përkundrejt qytetarëve, përfshi edhe personat LGBT. Ngritja e zyrave të ankesave të qytetarëve që menaxhohen në mënyrë të përbashkët me shoqërinë civile apo edhe Avokatin e Popullit, duhet parë me prioritet;
- Është po aq i nevojshëm trainimi i zyrtarëve publikë në lidhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, sistemin e referimit të rasteve, planifikimin e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror etj. Mos-njohja e ligjit nuk përbën një shkak për mos-zbatimin e tij, pavarësisht se në praktikë kjo ndodh shpesh. Në këtë aspekt forcimi i zyrave juridike pranë Bashkive apo krijimi i sektorëve të të drejtave të njeriut, do ta rriste ndër të tjera respektin dhe zbatimin e ligjeve, si dhe eliminimin në maksimum të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Referencat

Botime

Ambasada PINK, 2013, Manifesti i të Drejtave LGBT për Zgjedhjet Parlamentare 2013;

Avokati i Popullit, 2012, Raport i Posaçëm i zyrës së Avokatit të Popullit për LGBT

Council of Europe, 2010, .Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity Sociological Report: Albania, Danish Human Rights Institute /

European Union Agency for Fundamental Rights, 2014, European Union lesbian, gay, bisexual and transgender survey, , Vienna.

Fridrich Ebert Stiftung,, 2012, Rinia shqiptare 2011, mes besimit për të ardhmen dhe dyshimit për të tashme, Tiranë.

Hungarian Academy of Sciences, 2008 Social Exclusion of lesbian, gay, bisexual and transgender people in Hungary, Institute of Sociology;

ILGA Europe, 2006, Social Exclusion of lesbian, gay, bisexual and transgender people in Europe, , April 2006;

INSTAT, 2011, Census i Popullsisë, Tiranë.

Komisionerja për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2015. Raport i Posaçëm i Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2013) për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave LGBT në Republikën e Shqipërisë,

Komiteti Shqiptar i Helsikit, 2010, Aktet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, , Tiranë.

Ministry of Labor, Social Affairs and Equal Opportunities, 2015, .REPORT ON THE ACTION PLAN FOR NON-DISCRIMINATION ON THE BASIS OF SEXUAL ORIENTATION AND GENDER IDENTITY 2012-2014, Alida Tota

Nancy Fraser, 1997 From Redistribution to Recognition? Justice Interruptus, New York: Routledges

United Nations, 2013, The Universal Periodic Review: The situation of lesbian, gay, bisexual and trans (LGBT) people in Albania. Submitted to UN by: PINK Embassy / Alliance Against Discrimination of LGBT Albania / Ilga Europe, 3 September 2013.

United Nations, 2011, Discriminatory laws and practices and acts of violence against individuals based on their sexual orientation and gender identity, Report of the United Nations High Commissioner for Human Rights, November 2011.

Vendimi i zyrës së Komisioneres për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Nr.5, date 23.01.2014.

Legjislacion

Kushtetuta e Shqipërisë (1998)

Kodit Penal, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë (1977)

Kodi Penal i Shqipërisë (1995 / me shtesat e vitit 2014)

Kodi i Punës (me shtesat e vitit 2016)

Kodi i Procedurave Administrative (2015)

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2010)

Ligji për Arsimin Parauniversitar (2013)

Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (2000 / 2015)

Burime elektronike

Deklaratë Publike e Ambasadës PINK, për Dëmshtëpërblimin e të Dënuarve për Homoseksualizëm në periudhën komuniste (<http://www.pinkembassy.al/qeveria-t%C3%AB-d%C3%ABmshp%C3%ABrblej%C3%AB-t%C3%AB-gjith%C3%AB-personat-lgbt-t%C3%AB-d%C3%ABnuar-gjat%C3%AB-rregjimit-komunist>)

Gazeta “Koha Jonë”, Prill 1994. / Gazeta “Shqiptarja” Homoseksuali shqiptar: Ja si jetonim në kohën e monizmit (<http://shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=75719>)

Hillary Clinton diskuton për homofobinë në Shqipëri, mund të lexohet në këtë lidhje: <http://www.pinknews.co.uk/2010/06/24/hillary-clinton-discusses-subject-of-homophobia-in-albania/>

Raport i Situatës të të Drejtave të Njeriut të Personave LGBT në Shqipëri (2011-2014), Ambasada PINK. Aksesuar online në adresën: <http://www.pinkembassy.al/publikime/raporte-te-shkeljeve-te-te-drejtave-te-njeriut>

European Social Survey: Albania (2012), të dhenat mund të lexohen në këtë lidhje: https://www.osfa.al/sites/default/files/preliminary_findings_-_european_social_survey_in_albania_-_26_march_2013.pdf

ILGA-Europe Harta e Ylberit 2016, http://www.ilga-europe.org/sites/default/files/Attachments/side_b-rainbow_europe_index_may_2016_small.pdf

Një kopje e Rezolutës së Kuvendit mund të lexohet në këtë lidhje: https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2016/01/rezoluta_per_komunitetin_lgbt_dt_7_5_2015-3.pdf

Rreth AMBASADËS PINK

Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri është një organizatë jo-fitimprurëse e cila punon për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, interseks dhe queer në Shqipëri.

Zanafilla e punës sonë janë mesi i viteve 2000 me grupin e aktivistëve LGBT Pro pranë CRCA Shqipëri të cilët lobuan për avancimet e para ligjore dhe krijuan idenë e Ambasadës PINK. Programi i parë nisi me “Pink Embassy” falë mbështetjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në bashkëpunim me COC Hollandë, një nga organizatat më të vjetra LGBT në vend. Aktivitetet publike nisën zyrtarisht në 17 Maj 2010 me programin “PINK Embassy – krijimi i mundësive dhe inkurajimi i komunitetit LGBT në Shqipëri”. I shtrirë në një periudhë kohore tre vjeçare, ky program arriti të bëjë të njohur kauzën LGBT në Shqipëri përmes fushatave ndërgjegjësuere dhe komunikimit periodik mediatik, të stimulojë pjesëmarrjen dhe angazhimin e institucioneve publike dhe atyre për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të punojë për rritjen e kapaciteteve të tyre si dhe të garantojë hapësira sociale, kreative dhe emancipuese për komunitetin LGBT. Në harkun kohor 2010-2013 PINK u regjistrua si organizatë pranë organeve gjyqësore, ngriti një skuadër kompakte, të dedikuar dhe profesionale dhe punoi për koordinimin e gjithë grupeve të interesit në të mirë të kauzës LGBT në vend.

Me përpjekjet e saj dhe me mbështetjen e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë, në 17 Maj 2012 Ambasada PINK / LGBT Pro Shqipëri realizoi “Festivalin e Diversitetit”, i pari aktivitet publik i realizuar në vend në një mjedis të hapur. Ky ishte një nga momentet më vendimtarë për njohjen e gjerë të kauzës LGBT në vend.

Ambasada PINK / LGBT Pro ka besuar gjithmonë se arritja e fuqizimit të të drejtave LGBT nuk mund të arrihet pa përfshirjen e institucioneve përgjegjëse dhe komunitetit. Për këtë arsye në këto vite pune intensive është mundësuar ngritja e marrëdhënieve të punës me institucione si Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Bashkitë kryesore në vend etj. Në këto përpjekje ne falenderojmë të gjitha institucionet, organizmat dhe qeveritë e ndryshme që kanë mbështetur dhe vazhdojnë të mbështesin kauzën LGBT në Shqipëri në mënyrë aktive, serioze dhe miqësore. Miqtë tanë në këto përpjekje kanë qenë shoqëria civile shqiptare dhe organizata të shumta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të grave, fëmijëve, komuniteteve etnike, gjuhësore dhe kulturore, personave me aftësi të kufizuara etj.

Ne kemi punuar dhe lobuar për procese të ndryshme reformuese të tilla si ndryshime ligjore, plane veprimi dhe masash për kauzën LGBT, kemi shërbyer si një qendër kërkimore dhe informimi për çështjet LGBT brenda dhe jashtë vendit dhe kemi bërë maksimumin të krijojmë një mjedis mirëkuptues, emancipues dhe progresiv për njohjen e drejtë të kauzës LGBT në vend.

Ambasada PINK / LGBT Pro është anëtare e organizmave ndërkombëtare si ILGA Europe dhe IGLYO si dhe e rrjeteve të organizatave LGBT si Rrjeti Rajonal kundër Homofobisë dhe Transfobisë, BABELNOR etj.

Prej vitit 2014 Ambasada PINK / LGBT Pro po punon për realizimin e Pride-t të parë LGBT në Shqipëri, si dhe për avancimin e të drejtave të personave LGBT me politika qendrore dhe lokale, rritje kapacitetesh, lobim dhe advokim, programme trajnimi etj.

Fushat tona të përparësisë janë:

- Zbatimi i plotë i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- njohja ligjore e personave LGBT dhe garantimi i barazisë së tyre të plotë në raport me çdo qytetar tjetër të Shqipërisë;
- Njohjen dhe shprehjen e gjinisë nëpërmjet mbrojtjes dhe garantimit në ligj;
- garantimi i të drejtës së bashkëjetesës dhe martesës për personat LGBT;
- garantimi i të drejtës për të adoptuar fëmijë dhe krijuar familje;
- zbatimi i planit kombëtar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për avancimin e të drejtave LGBT;
- krijimi i qyteteve miqësore ndaj personave LGBT (qytetet ylber), për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave LGBT në nivel lokal;
- reformimi i sistemit arsimor në Shqipëri për integrimin e plotë të çështjeve LGBT, si çështje e të drejtave të njeriut, në kurrikulat e shkollave të vendit për një mirë-informim të brezave të rinj mbi çështje të orientimit seksual dhe identitetit gjinor;
- mbrojtja e adoleshentëve LGBT nga bulizmi dhe dhuna në shkolla si dhe luftimi i këtij fenomeni;
- mbrojtja e personave LGBT nga dhuna e krimet e urrejtjes dhe krijimi i një mjedisi dhe përqasjeje pozitive nga Policia e Shtetit;
- krijimi i mjediseve pranuese dhe pozitive brenda familjeve shqiptare me anëtarë LGBT etj;
- garantimi i shërbimeve mjekësore të përshtatshme për personat e LGB dhe krijimi i kushteve për ndërhyrjet kirurgjikale të personave transgjinorë.